



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 119

Tiranë – E hënë, 28 qershor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut nr. 20134/05, datë 7.2.2012	8331
Çështja Alimuçaj kundër Shqipërisë – Ankimi nr. 20134/05.....	



GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I KATËRT
ÇËSHTJA ALIMUÇAJ KUNDËR SHQIPËRISË
(Ankimi nr. 20134/05)

**VENDIM
STRASBURG**

7 shkurt 2012
ME FORMË TË PRERË
9.7.2012

Ky vendim ka marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44§2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në çështjen Alimuçaj kundër Shqipërisë,
Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
(Seksioni i Katërt), duke gjykuar si Dhomë e përbërë nga:

Nicolas Bratza, *president*,
Lech Garlicki,
Ljiljana Mijović,
Ján Šikuta,
Päivi Hirvelä,
George Nicolaou,
Vincent A. De Gaetano, *gjykatës*,
dhe Lawrence Early, *Sekretar i Seksionit*,

Pas shqyrtimit me dyer të mbyllura më 20 shtator 2011 dhe 17 janar 2012,

Shpall vendimin e mëposhtëm të miratuar në datën e përmendur së fundi:

PROCEDURA

1. Çështja e ka zanafillën në ankimin (nr. 20134/05) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar pranë Gjykatës sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) nga shtetasi shqiptar, z. Vehbi Alimuçaj (ankuesi), më 2 qershor 2005.

2. Ankuesi u përfaqësua nga z. Sh. Dizdari, avokat që ushtron aktivitetin e tij në Tiranë. Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga Agjencia e atëhershme e saj, znj. E. Hajro nga Avokatura e Shtetit.

3. Ankuesi pretendoi se kishte pasur shkelje të neneve 2 dhe 3 të Konventës për shkak se nuk i ishte dhënë trajtim i duhur mjekësor. Ai çmoi se parburgimi i tij kishte qenë në shkelje të nenit 5§§1 dhe 3 të Konventës. Më tej, ai u ankua sipas nenit 6§1 se procedimet kishin qenë të padrejta dhe

kishte pasur një shkelje të nenit 7 të Konventës.

4. Më 7 dhjetor 2009, Presidenti i Seksionit të Katërt vendosi të njoftonte Qeverinë në lidhje me kërkesën. U vendos, gjithashtu, të merrej vendim mbi pranueshmërinë dhe themelin e kërkesës në të njëjtën kohë (neni 29§1).

5. Ankuesi dhe Qeveria paraqitën individualisht vërejtjet me shkrim (neni 59§1).

6. Z. Ledi Bianku, gjykatës i zgjedhur në lidhje me Shqipërinë, u tërhoq nga gjykimi i çështjes (neni 28 i Rregullores së Gjykatës). Për rrjedhojë, Presidenti i Seksionit caktoi z. Jan Sikuta të vepronte si gjykatës *ad hoc* (neni 29§1(b)).

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

7. Kërkuesi ka lindur më 1949-n, në Vlorë, Shqipëri.

A. Procedurat e administrimit të detyrueshëm në lidhje me shoqërinë e ankuesit

8. Ankuesi ishte pronar dhe aksionar i vetëm i Vefa Holding sh.p.k., një shoqëri e themeluar fillimisht si shoqëri tregtare më 28 gusht 1992 (shoqëria). Pas zgjerimit të fushës së aktivitetit, shoqëria ndryshoi emrat e saj të regjistruar tri herë, për t'u regjistruar përfundimisht më 3 shkurt 1997 si "Vefa Holding sh.p.k." Nevoja e saj për zgjerim dhe pamjaftueshmëria e mundësive të huadhënies nga bankat tregtare në vend bëri që ankuesi dhe shoqëria e tij të merrnin hua nga individë, duke filluar në një datë të papërcaktuar në vitin 1994. Marrëveshjet e huave u lidhën sipas nenit 1050 të Kodit Civil.

9. Procesi i huamarrjes vazhdoi deri më 1997-n dhe u përhap në vend. Gjatë kësaj kohe autoritetet nuk kishin kërkuar të ndërhynin, me qëllim që të kontrollonin ose ndalonin procesin. Për më tepër, shoqëria ra dakord mbi pagimin e taksave dhe detyrimeve ndaj autoriteteve kompetente tatimore.

10. Më 1997-n, në Shqipëri ndodhën trazira civile për shkak të rënies së skemave të dyshuara piramidale, të cilat ishin krijuar gjatë viteve të mëparshme. Për rrjedhojë, Shteti ndërhyri dhe miratoi legjislacionin përkatës.

11. Më 23 janar 1997 u dekretua ligji për ndalimin e skemave piramidale (ligji nr. 1) (shihni "Ligji dhe praktika e brendshme përkatëse", më poshtë). Më 9 maj 1997, u miratua ligji për auditimin e subjekteve jobankare. Shoqëria iu nënshtroi legjislacionit të ri dhe administratorët u caktuan nga Qeveria.



12. Më 30 korrik 1997 u ndryshua ligji për auditimin e subjekteve jobankare (ligji nr. 2). Seksioni 3 i ligjit nr. 2 përjashtoi ndjekjen penale të personave të lidhur me subjektet jobankare deri në përfundimin e procedurave të administrimit të detyrueshëm. Në atë kohë Qeveria nuk kishte miratuar asnjë listë të personave të lidhur me subjektet jobankare. Një listë u miratua vetëm më 21 janar 1999 dhe emri i ankuesit nuk figuronte në të.

13. Procesi i administrimit duhet të kryhej në dy faza. Gjatë fazës së parë administratorët do të merrnin përsipër një kontroll të plotë të shoqërisë. Për kompensimin e aseteve, do të përpilohej një inventar i aseteve të shoqërisë dhe do të përgatitej një plan veprimi. Një auditim do të kryhej nga auditë të kualifikuar që do të emëroheshin nga Qeveria. Gjatë fazës së dytë, administratorët do të vazhdonin me shitjen e aseteve të shoqërisë dhe do të asistonin në procesin e rishpërndarjes për kreditorët e saj. Më tej, do të përgatiste një raport përfundimtar për Qeverinë dhe do të mbyllte procedurat.

14. Më 28 janar 2005, pas shitjes së aseteve të shoqërisë Qeveria miratoi një vendim mbi rishpërndarjen e aseteve financiare për kreditorët e shoqërisë kërkuese, mbi bazën e një koeficienti. Të ardhurat totale të mbledhura nga shitja ishin 3,800,000,000 lekë shqiptarë (LEKË), rreth 37,383,200 dollarë amerikanë (USD) në atë kohë. Borxhi i papaguar i shoqërisë mbeti 34,361,781,170 LEKË, rreth 338,040,000 USD në atë kohë.

15. Në një shkresë të datës 29 mars 2010 administratorët informuan Avokaturën e Shtetit se numri i përgjithshëm i kreditorëve ishte 73,509 nga të cilët 57,742 kishin përfituar nga procesi i rishpërndarjes. Deri tani, procesi është duke vazhduar për pjesën tjetër të kreditorëve.

16. Një përshkrim i hollësishëm i fakteve në lidhje me procedurat e administrimit të detyrueshëm mund të gjendet në çështjen *Vefa Holding sh.p.k. dhe Alimuçaj kundër Shqipërisë* (dhjetor.), nr. 24096/05, 14 qershor 2011.

B. Paraburgimi fillestar i kërkuesit

17. Më 12 prill 1998 administratorët kërkuan që ankuesi të ndiqej penalisht për mashtrim. Më 28 prill 1998 prokurori akuzoi ankuesin për mashtrim të kryer në bashkëpunim me të tjerë, dhe urdhëroi paraburgimin e tij. Ankuesi u arrestua po atë ditë.

18. Më 29 prill 1998, prokurori kërkoi vlefësimin e ndalimit të ankuesit për një periudhë të pacaktuar kohe. Më 30 prill 1998, ligjshmëria e arrestimit të ankuesit u konfirmua nga Gjykata e Rrethit, Tiranë (Gjykata e Rrethit). *Gjykata, pasi u njoh me materialet e çështjes, çmon se akuzat e prokurorit bazohet në një dyshim të arsyeshëm për provat e paraqitura nuk janë bindëse* dhe urdhëroi ndalimin e ankuesit për një periudhë prej vetëm pesëmbëdhjetë ditësh.

19. Më 2 maj 1998 prokurori apeloj kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit që kundërshtonte kohëzgjatjen e urdhrin të ndalimit dhe që çmonte se ekzistonin prova të mjaftueshme për të justifikuar ndalimin e ankuesit për një periudhë të pacaktuar kohe. Më 3 maj 1998, ankuesi paraqiti një apel drejtpërdrejt në Gjykatën e Kasacionit të asaj kohe, duke pretenduar se arrestimi i tij nuk ishte bazuar në prova bindëse (apeli i parë). Ai, gjithashtu, pretendoi se nuk mund të ndiqej penalisht mbi bazën e seksionit 3 të ligjit nr. 2.

20. Më 13 maj 1998, Gjykata e Apelit, Tiranë (Gjykata e Apelit) mbështeti apelin e prokurorit dhe urdhëroi ndalimin e ankuesit për një periudhë të pacaktuar kohe. Asnjë kopje e vendimit nuk u paraqit në këtë Gjykatë. Në një datë të papërcaktuar, ankuesi e apeloj vendimin në Gjykatën e Kasacionit (apeli i dytë).

21. Më 20 maj 1998, seksioni 3 i ligjit nr. 2 u ndryshua më tej duke lejuar ndjekjen penale dhe gjykimin e personave të lidhur me subjektet jobankare (ligji nr. 3). Ai përjashtonte fillimin e procedimeve civile.

22. Më 1 qershor 1998 Gjykata e Kasacionit e shpalli apelin e dytë të ankuesit të papranueshëm pasi arsyet e apelit ishin jashtë fushës së veprimit të nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

23. Meqë Gjykata e Kasacionit nuk e kishte shqyrtuar apelin e parë të ankuesit të 3 majit 1998, në një datë të papërcaktuar ankuesi kërkoi informacion rreth përfundimit të tij nga Gjykata e Kasacionit. Më 13 korrik 1998 Gjykata e Kasacionit rrëzoi apelin e parë për arsye se çështja e ankuesit kishte marrë fuqinë e *res judicata*, duke marrë në konsideratë vendimin e saj të datës 1 qershor 1998. Ankuesi u ankua për mungesë paanshmërie nga trupi gjykues, pasi të njëjtët gjykatës kishin shqyrtuar apelin e tij të parë dhe të dytë përkatësisht më 1 qershor dhe 13 korrik. Kërkesa e tij u kundërshtua nga Gjykata e Kasacionit.



24. Në një datë të papërcaktuar ankuesi apeloj në Gjykatën Kushtetuese. Ai u ankua se arrestimi i tij kishte qenë në kundërshtim me seksionin 3 të ligjit nr. 2. Për më tepër, ai pretendoi se apeli i tij i parë në Gjykatën e Kasacionit ishte shqyrtuar pas mbarimit të afatit dhjetë ditor të parashikuar me ligj. Ai nuk ngriti asnjë çështje në lidhje me mungesën e paanshmërisë së Gjykatës së Kasacionit.

25. Më 9 mars 1999 Gjykata Kushtetuese rrëzoi apelin e ankuesit. Ajo çmoi se Gjykata e Kasacionit kishte shtyrë shqyrtimin e apelit të parë të ankuesit derisa Gjykata e Apelit kishte vendosur mbi apelin e prokurorit. Apeli i parë ishte shqyrtuar pas përfundimit të këtyre procedimeve dhe çështja ishte konstatuar të përbënte *res judicata*. Në masën që ankimi i tij mbështetej në seksionin 3 të ligjit nr. 2, Gjykata Kushtetuese konstatoi se: “... dispozita [seksioni 3] ...ka pasur më shumë karakterin e një urdhërimi administrativ se sa të një norme procedurale penale. Duke pasur këtë natyrë, ajo ka qenë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese sepse ishte ndërhyrje e pushtetit legjislativ në atë gjyqësor, duke cenuar pavarësinë e këtij të fundit. Mosfillimi i proceseve penale për aq kohë sa do të vazhdonte kontrolli i firmave piramidale i hiqnin mundësinë organeve të prokurorisë të zbatonin detyrat kushtetuese të mbrojtjes së interesave të përgjithshme të shoqërisë, të rendit juridik dhe të të drejtave të shtetasve dhe, për çështje konkrete, e bënin të ndërvarur pushtetin gjyqësor nga ai ekzekutiv. Duke qenë para një dispozitë të tillë, prokuroria ka pranuar të respektojë detyrimet kushtetuese, duke mënjанuar urdhërimet e dispozitës në fjalë”.

26. Një opinion kundërshtues i Gjykatësve H.D dhe Z.V deklaroi se nëse dhe derisa seksioni 3 i ligjit nr. 2 nuk shpalleshin jokushtetues, ligji përjashtonte një hetim penal dhe procedime gjyqësore kundër ankuesit.

C. Ndalimi i vazhdueshëm i ankuesit

27. Në një datë të papërcaktuar pas vendimit të Gjykatës së Kasacionit të 13 korrikut 1998, ankuesi kërkoi rishikim të urdhrit të tij të ndalimit pranë Gjykatës së Rrethit. Rezulton se kërkesa nuk ishte shqyrtuar.

28. Më 28 korrik 1998, prokurori vendosi të shtynte afatin kohor për përfundimin e hetimit penal deri tre muaj, deri më 28 tetor 1998. Shtyrja e afatit kohor nuk rezultoi të jetë vlefshme nga gjykata.

29. Më 3 gusht 1998, ankuesi u ankua se ndalimi i tij ishte i padrejtë, me anë të shkresave të dërguara Presidentit të Republikës, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit.

30. Më 8 tetor 1998, ankuesi u ankua më tej se ndalimi i tij ishte i padrejtë, me anë të shkresave drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm dhe Kryetarit të Gjykatës së Rrethit. Ai kërkoi rishikim të ndalimit të tij.

31. Më 28 tetor 1998, prokurori vendosi të shtynte afatin kohor për përfundimin e hetimit penal me tre muaj të tjerë, deri më 28 janar 1999. Në të njëjtën ditë Gjykata e Rrethit vleftësoi vendimin e prokurorit por shtyu afatin kohor vetëm deri më 23 nëntor 1998. Ajo arsyetoi se nevoja për të verifikuar informacionin voluminoz në lidhje me aktivitetet komplekse të biznesit të shoqërisë së ankuesit përbënin arsye të bazuara për ndalimin e tij. Më 9 nëntor 1998, një apel nga ankuesi kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit u shpall i papranueshëm nga Gjykata e Kasacionit.

32. Më 10 nëntor 1998, ankuesi kërkoi rishikim të ndalimit dhe lirimin e tij nga burgu.

33. Më 16 nëntor 1998, ankuesi i kërkoi prokurorit që të kryente një sërë masash hetimore, duke përfshirë hartimin e një raporti kontabiliteti mbi situatën financiare të shoqërisë së tij. Në të njëjtën ditë, prokurori akuzoi ankuesin sipas nenit 333 të Kodit Penal (KP) për veprën e re penale shtesë të krijimit të organizatës kriminale. Gjykata e Rrethit nuk rezultoi të ketë konfirmuar afate të reja kohore në lidhje me akuzën e dytë.

34. Më 27 nëntor 1998, Gjykata e Rrethit rrëzoi kërkesën e ankuesit të datës 10 nëntor. Meqë ankuesi ishte akuzuar për krijimin e një organizate kriminale më 16 nëntor 1998, një periudhë e re paraburgimi prej dymbëdhjetë muajsh kishte filluar të llogaritej që nga ajo datë.

35. Më 2 dhjetor 1998, ankuesi apeloj drejtpërdrejt në Gjykatën e Lartë, e cila kishte zëvendësuar Gjykatën e Kasacionit pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës Shqiptare më 28 nëntor 1998. Ai deklaroi se meqë shoqëria e tij ishte vendosur nën administrim të detyrueshëm, nevoja për ndalimin e tij ishte ulur. Gjithashtu, ai iu referua gjendjes së tij shëndetësore. Më 18 shkurt 1999, Gjykata e Lartë rrëzoi apelin e tij si të pabazuar.

36. Më 27 janar 1999, prokurori vendosi të shtynte me tre muaj afatin kohor për përfundimin e hetimit penal, deri më 28 prill 1999. Gjykata e Rrethit nuk rezultoi të ketë konfirmuar afatin e ri kohor. Vendimi iu komunikua kërkuesit më 17 shkurt 1999.



37. Më 1 mars 1999, ankuesi kërkoi rishikimin e urdhrit të tij të ndalimit.

38. Më 10 mars 1999, prokurori vendosi të caktonte tre ekspertë që të përgatisnin një raport kontabiliteti. Atyre iu ngarkua detyra të jepnin informacion mbi dy pikat e mëposhtme: i) numri i përgjithshëm i kreditorëve të shoqërisë së ankuesit; dhe ii) pasivët e përgjithshëm të shoqërisë së ankuesit. Ankuesi kërkoi që ekspertët të jepnin informacion edhe mbi disa pika të tjera, si për shembull: përcaktimi i vlerës së aktivëve të shoqërisë në kohën që ishte ndaluar nga huamarrja; përcaktimi i shumës së taksave dhe tatimeve të paguara; situata financiare e shoqërisë në kohën që ishte vendosur nën administrim të detyrueshëm; përcaktimi i depozitave bankare të shoqërisë; përcaktimi i shumave të tërhequra dhe detyrimeve të shoqërisë ndaj palëve të treta; dhe të ardhurat që rrjedhin nga shitja e asetëve të shoqërisë. Rezultoi se të gjitha kërkesat e ankuesit u kundërshtuan nga prokurori.

39. Më 12 mars 1999 ankuesi u ankua pranë Prokurorit të Përgjithshëm për refuzimin e kërkesës së tij. Më 13 prill 1999 Prokurori i Përgjithshëm u përgjigj se pretendimet e ankuesit ishin të pabazuara.

40. Më 21 prill 1999 ekspertët paraqitën raportin e tyre, sipas të cilit numri i kreditorëve ishte 68,857 dhe pasivët e përgjithshëm të shoqërisë ishin 32,060,884,036 LEKË, ekuivalenti i 25,029,238 USD. Llogaritjet e tyre bazoheshin në informacionin që ishte paraqitur më parë dhe ishte trajtuar nga *Grupi Mbikëqyrës*.

41. Më 26 prill 1999, ankuesit iu dha akses te të gjitha dokumentet e grumbulluara gjatë hetimit penal dhe më 27 prill 1999 ai kishte detyrimin të paraqitej në gjykim.

42. Më 27 prill 1999 në Gjykatën e Rrethit u paraqit një aktpadi sipas së cilës ankuesi u akuzua se kishte kryer veprën penale të mashtrimit 68,857 herë.

D. Gjykimi i ankuesit

1. Vendimi i gjykatës së rrethit i 31 majit 2000

43. Në seancën e 10 nëntorit 1999, dy prej tre ekspertëve deklaruan se raporti ishte bazuar në prova të marra nga Grupi Mbikëqyrës. Megjithatë, ekspertët nuk ishin mbështetur në raportin e hartuar nga firma e auditëve të caktuar nga Qeveria më 24 qershor 1998, që kishte llogaritur pasivët e shoqërisë së ankuesit në 688,655,717 USD. Ata nuk

kishin mundur të llogarisnin vlerën monetare të pasurisë së zotëruar nga shoqëria e ankuesit ose aftësinë e saj për të shlyer borxhet e papaguara pasi kjo ishte jashtë termave të tyre të referencës. Në llogaritjen e shumës ekspertët kishin zbritur interesin e kapitalizuar.

44. Më 10 maj 2000, ankuesi i kërkoi gjykatës të merrte në pyetje administratorët F.A. dhe H.G. dhe të siguronte raportin e administratorëve mbi situatën e shoqërisë së tij. Më 15 maj 2000, ankuesi kërkoi sërish që administratori N.A. të thirrej për t'iu përgjigjur pyetjeve në lidhje me vlerësimin e asetëve të shoqërisë së tij, shitjen e tyre dhe përfundimin e procedurave të administrimit të detyrueshëm. Nuk është e qartë se cilat masa ishin marrë në përgjigje të kërkesave të tij.

45. Më 29 maj 2000, ankuesi bëri parashtrimet e tij përfundimtare. Ai pretendoi se fillimi i ndjekjes penale ishte në shkelje të seksionit 3 të ligjit nr. 2 dhe nuk duhet të kishte filluar përpara përfundimit të procedurave të administrimit të detyrueshëm. Ai u ankua se ishte mbajtur në paraburgim tej afatit të arsyeshëm. Gjithashtu, ai argumentoi se ishte privuar nga liria për arsye të paafetësisë për të përmbushur një detyrim kontraktual, në shkelje të nenit 27§3 të Kushtetutës. Për sa i përket raportit financiar të ekspertëve, ai çmoi se nuk ishte bërë asnjë vlerësim i vlerës së pasurisë së tij, me synim që të konstatohej nëse kreditorët mund të shlyheshin. Për më tepër, në kundërshtim me nenin 270 të KPP-së, prokurori nuk kishte vazhduar të konfiskonte pasurinë e tij.

46. Në një vendim të hollësishëm të datës 31 maj 2000, Gjykata e Rrethit e shpalli ankuesin fajtor për mashtrim dhe e dënoi me pesë vjet burgim. Gjykata e shfajësoi ankuesin nga akuza e krijimit të një organizate kriminale. Në fakt, ajo pranoi se kjo akuzë ishte paraqitur me qëllim që të shtyhej paraburgimi i ankuesit pasi afatit kohor po i afrohej fundi.

47. Dhjetë faqet e para të vendimit jepnin një përshkrim të hollësishëm të krijimit të shoqërisë së ankuesit, veprimtarive të saj dhe *modus operandi*. Sipas Gjykatës së Rrethit, zhvillimi dhe progresi i shoqërisë së ankuesit përbëhej nga dy faza. Faza e parë e zhvillimit shtrihej nga viti 1992 deri 1994 gjatë së cilës veprimtaria ekonomike dhe tregtare e shoqërisë përqendrohej në sferën e bizneseve me të ardhura të shpejta, të cilat mbështeteshin në para në dorë/të holla, si për shembull furra buke,



dyqane shitjeje me pakicë, ëmbëltoje, restorante dhe agjenci udhëtimi. Faza e dytë shtrihej nga fundi i vitit 1994 deri në vendosjen e shoqërisë nën administrim. Gjatë kësaj periudhe synimi i shoqërisë ishte që të modernizonte linjat e saj të prodhimit dhe të shtrinte veprimtaritë e saj brenda dhe jashtë vendit. Sipas pikëpamjes së gjykatës, kjo ishte periudha vendimtare që shkaktoi probleme të mëdha financiare dhe ekonomike. Gjykata e Rrethit pranoi se arsyeja kryesore për huamarrjen nga qytetarët ishte ritmi i shpejtë i zgjerimit dhe zhvillimit të shoqërisë, si dhe pamundësia reale e bankave shqiptare që të jepnin hua.

48. Vendimi përcaktoi më tej se procesi i huamarrjes nga qytetarët vazhdoi deri më 23 janar 1997. Nga fundi i 1994 dhe fillimi i vitit 1995, kontratat e huave përbëheshin nga një shkresë e thjeshtë dhe normat e ofruara të interesit që varionin nga 5% deri 6% në muaj. Numri i përgjithshëm i personave që lidhnin kontratë huaje me shoqërinë ishte 68,857 kreditorë. Sasia e përgjithshme e huave të marra, mbi bazën e llogaritjeve të bëra nga organet dhe ekspertët e specializuar, ishte e barasvlershme me 325,300,000 USD. Kjo shifër nuk ishte e saktë pasi rezultatet përfundimtare nuk ishin përgatitur ende.

49. Dymbëdhjetë faqet e ardhshme të vendimit përqendroheshin në situatën financiare të shoqërisë së ankuesit. Gjykata analizoi bilancet e shoqërisë për periudhën nga viti 1993 deri 1996, mbi bazën e deklarimeve tatimore vjetore të shoqërisë. Ajo nxori përfundimin se bilancet tregonin një inflacion të pajustificuar të aseteve të shoqërisë, me qëllim që të mbulonte borxhet e mëdha që kishte shkaktuar nëpërmjet huamarrjes nga qytetarët. Për më tepër, gjykata shqyrtoi disa transaksione dhe shpenzime që ishin shkaktuar në nivel vendi dhe jashtë vendit ose nga shoqëria, ose nga ankuesi, me qëllim që të theksonte natyrën e tyre të paligjshme.

50. Në shpalljen e veprimeve të ankuesit si të paligjshme dhe shpalljen fajtor të ankuesit, Gjykata e Rrethit deklaroi si më poshtë:

“Së pari, ankuesi hyri në marrëveshje huaje me individë me një periudhë maturimi nga 6 deri 12 muaj. Kjo është në kundërshtim me seksionin 6 të ligjit për sistemin bankar në Shqipëri të vitit 1996, i cili deklaroi se ‘asnjë subjekt tjetër, me përjashtim të një banke, nuk mund të pranojë depozita nga qytetarët, me periudhë fillestare maturimi prej 12 muaj ose më pak’.

Së dyti, me lidhjen e marrëveshjeve të huave dhe pranimit të huave, shoqëria e ankuesit i ofroi kreditorëve një parapagim prej dy për qind të interesit të tyre të shtuar, një veprim disi i çuditshëm për shkak të natyrës së shoqërisë si subjekt investues.

Së treti, ankuesi kreu veprime, kryesisht ndryshimin e vlerave reale të bilanceve për vitin 1994, 1995 dhe 1996, në shkelje të ligjit të kontabilitetit të vitit 1993.

Së katërti, disa transaksione ishin bërë me para në dorë/të holla, duke shmangur kështu hyrjet e ligjshme në të dhënat e llogarive...

Së pesti, normat e interesit të ofruara nga shoqëria e ankuesit të cilat varionin nga 6 % deri 8 % në muaj, ishin tepër të larta në krahasim me normat e interesit të ofruara nga bankat [tregtare]. Për më tepër, shoqëria e ankuesit kreu veprime arbitrare të njëanshme që madje shkelnin detyrimet e tij kontraktuale, duke ulur normën e interesit pa pëlqimin paraprak të kreditorëve.

Së gjashti, detyrimet kontraktuale ndaj kreditorëve u përmbushën duke tërhequr në mënyrë të vazhdueshme hua të reja nga qytetarët ...

Së shtati, aktiviteti ekonomik i shoqërisë ishte në kundërshtim me ligjin e shoqërive tregtare të vitit 1992 pasi aktiviteti i huamarrjes sipas Kodit Civil lejohet vetëm midis individëve. Kontrolllet konstatojnë se janë raportuar raste kur huat bëheshin për shoqërinë ankuese.

Së teti, ankuesi dhe shoqëria e tij rritën qëllimisht vlerën e aseteve të tyre për të pasur një bilanc pozitiv për shoqërinë...

Së nënti, ankuesi pagoi çmime tepër të larta, më shumë se vlera reale e tregut, për blerjen e objekteve me një normë më të ulët kthimi në krahasim me shpejtësinë dhe ritmin e shpejtë të tërheqjes së parave.

Së dhjeti, rritja e shpenzimeve të panevojshme për blerjen e artikujve luksozë dhe shpenzimet e larta për kostot e personelit nuk përkonin me realitetin. ...

Së njëmbëdhjeti, gjatë aktiviteteve tregtare të ankuesit dhe shoqërisë së tij, ka pasur transferime parash për blerjen e objekteve dhe pronave... pa garanci ose normë interesi, pavarësisht nga fakti se paratë ishin marrë nga qytetarët me një normë interesi prej tetë për qind në muaj. Në shumicën e rasteve këto shuma nuk figurojnë në bilancin e shoqërisë.

Së dymbëdhjeti, mbi bazën e bilanceve të paraqitura nga shoqëria pranë autoriteteve tatimore në vitet 1995–1997... niveli i fitimeve në krahasim me tërheqjen e parave nga kreditorët nuk ishte më shumë se katër për qind. Të marrë në pyetje në një seancë, ekspertët nxorën përfundimin se duke marrë parasysh fitimin e nxjerrë dhe nivelin e aseteve të vlerësuar nga



auditët, nuk mund të kishte dyshim për kthimin e shumës së principalit, pa përmendur interesin pagues.

Së trembëdhjeti, gjatë funksionimit të shoqërisë, kryesisht pas miratimit të ligjit për ndalimin e skemave piramidale të vitit 1997, kishte një model transferimesh të parave me anë të parave në dorë për në vende të ndryshme, veçanërisht Zvicër, që dyshoheshin për blerjen e aksioneve, bankave ose për të krijuar aktivitete të tjera, në mënyrë që shoqëria të supozohej të shqyrtonte mënyra për vazhdimin dhe mbijetesën e saj.

Së katëmbëdhjeti, kontratat e huave nuk ishin lidhur para noterit në përputhje me ligjin për noterinë [1992] dhe Kodin Civil; ato janë kontrata të standardizuara, me detyrime të përcaktuara...të lidhura pa kërkuar pëlqimin e kreditorit dhe pa garanci pasurore.”

51. Në lidhje me pretendimet e ankuesit mbi ndalimin dhe dënimin e tij që lindin nga paaftësia e tij për të përmbushur detyrimet kontraktuale, vendimi shprehet si më poshtë:

“...gjykata [e rrethit] nuk i futet detyrimit civil në mënyrë të drejtpërdrejtë por se me veprimet dhe mosveprimet e tij dhe mospërmbushjes së detyrimeve civile, ankuesi ka lindur një vepër penale dhe konkretisht me anë të veprimeve të kundërligjshme që nga momenti i fillimit [të aktiviteteve të bizneseve të shoqërisë]e deri në momentin aktual të gjykimit janë mënjeluar apo shkelur, apo lënë pa zbatuar një sërë dispozitash ligjore të cilat ne i përmendëm më sipër).

Duhet theksuar se veprimtaria e huamarrjes nuk është një veprim i drejtpërdrejtë civil pasi kontratat janë bërë pa garanci pasurore, niveli i interesave ka qenë tej normativave ligjore, kemi fshehje të të ardhurave dhe rrjedhje të pasurisë).”

52. Gjykata e Rrethit rrëzoi kërkesën e prokurorit për të dënuar ankuesin në bazë të 68,857 akuzave, e barabartë me numrin e përgjithshëm të kreditorëve. Ajo deklaroi se ankuesi ishte akuzuar për vetëm një vepër penale. Vepra në fjalë kishte filluar në 1994 dhe kishte përfunduar më 23 janar 1997, duke përbërë kështu një krim të vazhdueshëm më tepër sesa një krim të përsëritur. Gjykata çmoi se neni 55 i Kodit Penal nuk mund të zbatohet për çështjen në fjalë pasi ankuesi kishte kryer vetëm një vepër penale. Gjykata e Rrethit iu referua më tej vendimit të asaj kohe të Gjykatës së Kasacionit të datës 14 korrik 1998, i cili kishte dënuar një individ tjetër vetëm një herë, në përputhje me nenin 143 të Kodit Penal, kryesisht mbi të njëjtat fakte dhe rrethana si të ankuesit.

Faqe | 8336

2. Vendimi i Gjykatës së Apelit i 24 dhjetorit 2001

53. Në një datë të papërcaktuar në qershor 2000, ankuesi dhe prokurori apeluan. Ankuesi argumentoi se ai ishte dënuar për shkak të paaftësisë së tij për të përmbushur një detyrim kontraktual që rrjedh nga marrëveshjet e huas të lidhura me kreditorët e tij. Megjithatë, asnjë kreditor nuk kishte akuzuar ankuesin për mashtrim. Për këtë qëllim, të paktën 40 kreditorë ishin marrë në pyetje nga gjykata dhe të gjithë kishin deklaruar se ata i kishin dhënë hua ankuesit me dëshirën e tyre dhe kishin tërhequr interesin në datën e rënë dakord në marrëveshje. Ankuesi çmoi se Kodi Civil nuk përcaktonte se një marrëveshje huaje mund të lidhej vetëm midis dy individëve privatë. Gjithashtu, ankuesi kundërshtoi vlerësimin e provave nga Gjykata e Rrethit dhe pamundësinë e saj për të shqyrtuar nëse ai ishte i aftë të përmbushte detyrimet e tij kontraktuale ndaj kreditorëve.

54. Në një datë të papërcaktuar në maj 2001, Gjykata e Apelit caktoi këta tre ekspertë që të përgatisnin një raport tjetër financiar.

55. Më 17 tetor 2001, ekspertët paraqitën raportin e tyre. Sipas raportit, numri i përgjithshëm i kreditorëve ishte 57,923 dhe borxhi i përgjithshëm arrinte shumën prej 29,249,622,461 LEKË, ekuivalenti i 199,045,000 USD në atë kohë. Kjo shifër u nxor nga kompjuterët e shoqërisë, të cilët ishin konfiskuar nga prokuroria. Duke iu referuar numrit të pretendimeve të bëra nga kreditorët pas fillimit të procedurave të administrimit të detyrueshëm, raporti tregoi se numri i përgjithshëm i kreditorëve ishte 38,652, ndërsa borxhi i përgjithshëm ishte 127,019,677 USD.

Në lidhje me vlerën e asetëve të shoqërisë së ankuesit, raporti nxori përfundimin se që nga 27 qershori 1997, asetet e tij arrinin vlerën e përgjithshme prej 336,563,915 USD. Kjo llogaritje u bazua në një vendim të Gjykatës së Rrethit të datës 27 qershor 1997, i cili rendiste pasuritë e shoqërisë dhe vlerën përkatëse monetare. Megjithatë, ai nuk përfshinte vlerën e minierave dhe rezervave të tjera minerare.¹

1. Vendimi i Gjykatës së Rrethit i datës 27 qershor 1997, vendosi të pranojë një kërkesë nga shoqëria e ankuesit për një rritje të kapitalit të tij në shumën prej 797,816,311,000 lekë (rreth ekuivalentit në 5,147,202,006 USD sipas normës së këmbimit në atë kohë).



Pas fillimit të procedurave të administrimit të detyrueshëm, vlera e përgjithshme e asetëve të shoqërisë së ankuesit arrinte në 14,683,493 USD, nga të cilat 8,675,975 USD përbëheshin nga të ardhurat nga shitja e asetëve dhe 6,007,513 USD llogaritej vlera e asetëve që nuk ishin shitur ende.

Për sa i përket llogarisë së hyrjeve dhe daljeve në llogaritë bankare të shoqërisë, raporti nxori përfundimin se bilanci i saj ishte 11,533,063 USD. Megjithatë, jo të gjitha bankat kishin paraqitur raporte të llogarisë së hyrjeve dhe daljeve. Borxhi i papaguar që detyrohej nga palët e treta për shoqërinë e ankuesit ishte llogaritur në 18,453,348 USD. Raporti vlerësoi dëmin ndaj asetëve të shoqërisë së ankuesit si rezultat i trazirës civile të vitit 1997, në 201 milionë USD.

56. Në vendimin e saj të 24 dhjetorit 2001, Gjykata e Apelit u mbështet në faktet e konstatuara në vendimin e Gjykatës së Rrethit. Ajo e shpalli kërkesin përgjegjës për mashtrimin e 57,923 kreditorëve në shumën e përgjithshme prej 29,249,622,461 LEKË. Gjykata shpjegoi uljen e numrit të përgjithshëm të kreditorëve dhe shumën e përgjithshme të borxhit me zbritjen e interesit të kapitalizuar dhe përjashtimin e të dhënave të pasakta. Më tej, gjykata kundërshtoi shifrat që lindnin nga procedurat e administrimit të detyrueshëm si të pasakta, duke pasur parasysh faktin se jo të gjithë kreditorët mund të ishin paraqitur për të dorëzuar pretendimet e tyre.

57. Gjykata e Apelit e dënoi ankuesin me njëzet vjet burgim, në përputhje me nenin 143§2 të Kodit Penal, i cili hyri në fuqi më 24 janar 2001.

3. Vendimi i Gjykatës së Lartë i 22 nëntorit 2002

58. Më 22 janar 2002, ankuesi depozitoi një apel. Ai u ankua rreth zbatimit prapaveprues të nenit 143§2 të Kodit Penal, i cili kishte rënduar pozicionin e tij. Ai pretendoi se Gjykata e Apelit nuk i kishte dhënë kohë të përgatiste mbrojtjen e tij kur kishte bërë ricilësimin e veprës penale dhe e kishte dënuar sipas nenit 143§2 të Kodit Penal. Më tej, ankuesi pohoi se asnjë prej kreditorëve të tij nuk ishte marrë në pyetje para gjykatave më të ulëta ose nuk ishte ankuar rreth kontratave që kishte lidhur me ta. Në lidhje me veprën penale për të cilën është akuzuar, ai deklaroi se kishte investuar të gjitha paratë që kishte marrë nga qytetarët. Nuk kishte pasur asnjë synim për të gënjyer ose për të abuzuar me besimin nga ana e tij. Ky pohim u mbështet nga numri i madh i asetëve që shoqëria e

tij zotëronte dhe menaxhonte. Së fundi, ankuesi pretendoi se ulja në vlerën e pasurive të tij kishte ndodhur për shkak të keqmenaxhimit të administratorëve dhe trajtimit të papërshtatshëm të shitjes së asetëve të shoqërisë së tij.

59. Më 22 nëntor 2002, Gjykata e Lartë e shpalli ankuesin fajtor sipas akuzës. Duke u mbështetur në të njëjtat fakte të konstatuara në vendimet e gjykatave më të ulëta, Gjykata e Lartë çmoi se veprimet e ankuesit dhe aktivitetet e shoqërisë kishin qenë të papërshtatshme dhe të paligjshme. Vendimi i Gjykatës së Lartë, në masën që lidhet me çështjen, përcakton si më poshtë:

“Mbi bazën e sasisë së madhe të materialeve, dokumenteve dhe raporteve të ekspertëve që ishin paraqitur në gjykim dhe gjykatat e apelit, është e qartë se i pandehuri mblodhi shuma të konsiderueshme parash dhe monedhe të huaj nga qytetarët me anë të premtimeve të rreme për të shlyer shumat dhe për të paguar norma të larta interesi, duke e ditur se ishte i paaftë për të mbajtur premtimet. Në kundërshtim me pretendimet e të pandehurit, gjykatat [më të ulëta] konstatuan se marrja e parave nga qytetarët në formën e të ashtuquajturave hua, ishte kryer për qëllimin e vetëm të përfutimit të pasurive për vetë të pandehurin dhe për persona të tjerë. I pandehuri nuk ishte i aftë të siguronte shumat në fjalë, duke u mbështetur vetëm te paratë e marra nga qytetarët dhe ai e dinte se nuk mund të nxirrte fitime në mënyrë të ligjshme, me qëllim shlyerjen e huave.

Sipërmarrja për të kthyer paratë e mbledhura nga qytetarët nuk ishte bazuar në fitimet e arsyeshme të nxjerra nga shoqëria por në perspektivën e tërheqjes së parave në të njëjtën mënyrë nga qytetarë të tjerë. Gjykatat [më të ulëta] konstatuan se asnjë shoqëri tregtare normale dhe e ligjshme nuk mund të siguronte normat e interesit të nevojshme për të mbuluar normën e lartë të interesit që i pandehuri i ofronte personave nga të cilët ai mblidhte shuma marramendëse parash.

Në rritjen artificiale të vlerës së investimeve që kishte bërë duke përdorur paratë e marra nga qytetarët, qëllimi i të pandehurit ishte që të tërhiqte një numër të madh personash, në përgjigje të konkurrencës nga të ashtuquajturat fondacione dhe skema të tjera piramidale të cilat funksiononin në atë kohë, dhe të rrënjosnin te qytetarët idenë e rreme se ai zotëronte pasuri dhe asete të tjera që do të siguronin detyrimet në të cilat ishte përfshirë. Rritja e normave të interesit për kreditorët dhe shkurtimi i afateve për shlyerjen e huave hynte në të njëjtën kategori.

Duke marrë parasysh të gjithë grupin e provave që ishin analizuar hollësisht nga Gjykata e Rrethit dhe nga Gjykata e Apelit, rezulton se duke përdorur paratë e



marra nga qytetarët, i pandehuri krijoi një skemë piramidale baza e së cilës përbëhej nga huat e mbledhura nga qytetarët të cilët ishin mashtruar ndërsa kulmi i saj përbëhej nga shlyerjet që, siç ishte vendosur nga gjykatat, nuk ishin të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet [kontraktuale] të të pandehurit.

...

Nga hetimi dhe dosja e çështjes rezulton se synimi kriminal për kryerjen e vjedhjes me anë të mashtrimit kishte filluar në 1994 nëpërmjet procesit të huamarrjes. Me kalimin e kohës ky synim përparoi ndërsa ankuesi zgjeroi aktivitetet e tij, i cili mori përmasa të jashtëzakonshme kur skema çarkulloi në të gjithë vendin deri më 23 janar 1997, datë që shënoi fundin e skemës së tij piramidale.

Fillimisht dokumenti i përdorur nga shoqëria për huamarrje përbëhej nga një letër e thjeshtë, ose mandat. Normat e interesit varionin nga 5% deri 6% në muaj. Kjo i korrespondonte periudhës midis fundit të vitit 1994 dhe fillimit të vitit 1995.

Me kalimin e kohës dokumentet u ndryshuan dhe morën formë më stereotipe, duke përfshirë emrin dhe mbiemrin e huadhënësit, të referuar si kreditori dhe emrin e huamarrësit, d.m.th, të pandehurit. Këto dokumente të cilat ishin të njëjta si ato të përdorura në skema të tjera piramidale- të ashtuquajturat fondacione- ishin përdorur në mënyrë të njëanshme dhe sistematike, për të gënjyer, mashtruar dhe shpërdoruar besimin e mijëra njerëzve të varfër, të cilët ëndërronin të fitonin para nga i pandehuri.

Më 1996-n, i pandehuri shpiku një përpunim të skemës, në bazë të mashtrimit dhe gënjeshtrove, kur lëshoi të ashtuquajturat libreza kursimi, të cilat nuk u vunë asnjëherë në përdorim.

Me qëllim rritjen e besimit të kreditorëve dhe, gjithashtu, për ta lehtësuar procesin e vjedhjes dhe mashtrimit të tyre, i pandehuri ngriti normat e interesit në 8% ndërsa aplikonte norma më të larta interesi për rrethin e tij më të ngushtë [të të njohurve], të cilët promovonin mrekullitë e kryera nga shoqëria e tij.

...

Është e qartë se Vefa, megjithëse u zgjerua në vend dhe përbëhej nga shumë degë ndihmëse, ekzistonte si njësi e vetme financiare dhe ekonomike. Edhe bilanci e shoqërisë u paraqitën si një bilanc i vetëm që mbulonte të gjithë shoqërinë. Më konkretisht, sipas bilancit të vitit 1993, shoqëria kishte një fitim neto që arrinte në 63,000 LEK dhe një forcë punëtoresh prej gjashtë personash. Sipas bilancit të vitit 1994, fitimi neto i shoqërisë ishte 305,928 LEKË, i cili ishte i barabartë me 0.04% të borxhit të papaguar që i detyrohej kreditorëve të tij.

Në 1995 pati një rritje në numrin e huave [bërë nga qytetarët]. Për rrjedhojë, bilanci i Vefës pasqyroi vlera të rritura. Fitimi neto i shoqërisë për atë vit arrinte

73,150,201 LEKË, ekuivalenti i 0.02% i borxhit të papaguar që i detyrohej kreditorëve të tij.

Nga viti 1996 procesi i huamarrjes kishte marrë përmasa pa precedent dhe për rrjedhojë fitimet neto të shoqërisë arrinin shumën e përgjithshme prej 2,125,882 USD, ekuivalenti i 0.004% të borxhit të papaguar që i detyrohej kreditorëve të tij.

60. Gjykata e Lartë mbështeti konkluzionet e Gjykatës së Apelit në lidhje me numrin e përgjithshëm të kreditorëve, d.m.th., 57,923. Megjithatë, ajo nxori përfundimin se shumica e përgjithshme e pasivëve të ankuesit ishte 22,374,141,130 LEKË (rreth 157,453,000 USD në atë kohë) pasi kishte zbritur llogaritë e hyrjeve dhe daljeve të shoqërisë, që arrinte shumën e përgjithshme prej 6,875,481,331 LEKË. Vendimi i Gjykatës së Lartë, në masën që lidhet me çështjen, përcakton si më poshtë:

“... Çdo ndryshim i mundshëm në numrin e kreditorëve nuk cenon fajësinë e të pandehurit ose dënimin e tij në lidhje me veprën që ka kryer. Një vendim gjykate i formës së prerë në çështjen penale është detyrues për gjykatën që shqyrton detyrimet civile vetëm në masën me të cilën lidhet kryerja e veprës penale dhe nëse vepra penale ishte kryer nga i pandehuri. Kjo nuk ka pasoja për zgjidhjen e procedimeve civile që mund të fillojnë në të ardhmen.

Gjatë fazës së hetimit, si dhe në gjykimin dhe procedimet e apelit, i pandehuri pretendoi se meqë veprimet e tij ndaj kreditorëve përbënin marrëdhënie civile në formën e përmbushjes së një detyrimi kontraktual që rrjedh nga huat e marra, ato nuk mund të përbënin shkak për përgjegjësi penale. Ky argument u rrëzua nga gjykatat e brendshme si i pabazuar. I pandehuri, gjithashtu, u ankua se nuk ishte kryer asnjë vepër penale, duke argumentuar se pasuria në zotërim të tij ishte shumë më e madhe sesa vlera e detyrimeve të tij ndaj kreditorëve.

Gjykatat [më të ulëta], pas vlerësimit të provave që zotëronin, nxorën përfundimin se ky pretendim ishte i pabazuar. Perceptimi i të pandehurit nga qytetarët si pronar i pasurive të mëdha ishte një prej formave të mashtrimit që ai përdorte për të tërhequr shumica të mëdha parash nga qytetarët. Gjykata vëren se gjykatat [më të ulëta] nxorën këtë përfundim mbi bazën e dokumenteve voluminoze, shpjegimeve të dhëna nga raportet e ekspertëve që ishin përpiluar. ... Për sa i përket vlerësimit të objekteve, vlera e tyre nuk pasqyron realitetin pasi vlerësimi ishte i njëanshëm dhe ishte rritur artificialisht në krahasim me çmimin e blerjes dhe vlerën reale të tregut. Gjykata e Rrethit arriti të njëjtin përfundim nëpërmjet një arsytimi më të hollësishëm.

Në këto rrethana, gjykatat [më të ulëta] pranuan se i



pandehuri kishte kryer veprën penale të vjedhjes me anë të gënjeshtreve dhe shpërdorimit të besimit.”

61. Gjykata e Lartë çmoi se Gjykata e Apelit nuk kishte zbatuar si duhet nenin 143§2 të Kodit Penal. Në miratimin e dënimit ndaj ankuesit, Gjykata e Lartë arsyetoi se ai duhet të mbajë përgjegjësi penale për aq akuza sa numri i përgjithshëm i kreditorëve, d.m.th., 57,923, në përputhje me nenin 143§1 të Kodit Penal, i cili parashikonte një dënim me pesë vjet burgim. Duke iu referuar nenit 55 të Kodit Penal, ajo vendosi se bashkimi i dënimeve nuk duhet të tejkalojë dënimin maksimal prej njëzet vjet burgim. Për rrjedhojë, e dënoi ankuesin me njëzet vjet burgim. Gjykata e Lartë rrëzoi argumentin e ankuesit se, duke bërë ricilësimin e veprës penale, Gjykata e Apelit nuk i kishte dhënë kohë të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij.

62. Në këtë kontekst, pjesët përkatëse të vendimit janë si më poshtë:

“Gjykata e Rrethit, Tiranë, e dënoi të pandehurin për mashtrim dhe zbatoi nenin 143 vetëm një herë. Gjykata e Apelit, ndërsa shpallte se dënimi i të pandehurit për vetëm një akuzë sipas nenit 143 ishte i pabazuar, nuk cilësoi si duhet veprën penale, duke e shpallur të pandehurin fajtor dhe duke e dënuar atë sipas nenit 143§2 të Kodit Penal. Në vendimin e saj, Gjykata e Apelit, duke u mbështetur në nenin 3§3 të Kodit Penal, arsyetoi se vepra penale duhet të klasifikohet sipas nenit 143§2 të Kodit Penal, për arsye se, si një dispozitë e sapo prezantuar e së drejtës penale, kjo e fundit ishte më e favorshme sesa dispozitat e mëparshme.

Argumenti i përdorur nga Gjykata e Rrethit se vepra penale përbën një krim të vazhdueshëm... nuk lind nga mashtrimi që është kryer. Me qëllim që një krim të jetë i vazhdueshëm, duhet të jenë të pranishëm elementët e mëposhtëm: çdo veprë penale nuk duhet të qëndrojë si akt më vete, veprimi ose mosveprimi duhet të kenë përfaqësuar të njëjtën veprë penale dhe duhet të ekzistojë mendimi kriminal që bashkon vepra të veçanta në një tërësi të vetme të pandashme.

Në çështjen në fjalë, gjykatat [më të ulëta] kanë pranuar se i pandehuri ka kryer vepra të ndryshme gjatë periudhave të ndryshme kohore. Aktiviteti kriminal u zhvillua brenda një kohe të gjatë dhe, siç është argumentuar më lart, nuk ishte pasojë e të njëjtit synim kriminal. Ky i fundit i ishte nënshtruar ndryshimit të vazhdueshëm për shkak të konkurrencës nga shoqëri të tjera të paligjshme huamarrëse. Kjo mori formën e normave të ndryshueshme të interesit, teknikave të ndryshme të mashtrimit për t’iu përshtatur njerëzve të ndryshëm dhe rrethanave të ndryshme, zhvillimit të strategjive të ndryshme për ta bërë mashtrimin të

besueshëm, qoftë nëpërmjet propagandës në mediane e shkruar dhe vizive ose përmes përpjekjeve për ta bërë aktivitetin kriminal të duket si aktivitet bankar normal.

Gjykata mban të njëjtin qëndrim me vendimin unifikues (nr. 284) të 15 shtatorit 2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me qëllim që personat të cilët kanë kryer veprën e mashtrimit do të kenë përgjegjësi penale sipas nenit 143 të Kodit Penal për aq akuza sa numri i personave të mashtruar.

Gjykata e Lartë çmon se arsyetimi i Gjykatës së Apelit se neni 143§2 duhet të zbatohet pasi është më i favorshëm, nuk ka bazë ligjore. Neni 82§2 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se “vepra penale më e rëndë konsiderohet të jetë ajo që parashikon dënimin maksimal më të lartë ose, kur dënimet maksimale më të larta janë të barabarta, dënimi minimal më i lartë.” Mbi këtë bazë, duke e konsideruar dënimin maksimal më të lartë si kriter për veprën penale më të rëndë, është e qartë se neni 143 i Kodit Penal, i cili ishte në fuqi kur ishte kryer vepra penale dhe që parashikon një dënim me pesë vjet burgim, është më i favorshëm sesa paragrafi i dytë që i ishte shtuar dispozitës dhe parashikon një dënim maksimal prej njëzet vjet burgim. Fakti që bashkimi i dënimeve i vendosur mund të jetë më i lartë sesa dënimi i parashikuar në nenin 143§2 të Kodit Penal, nuk mund të përbëjë arsye për të konstatuar se neni 143 është më pak i favorshëm.

Për këto arsye, Gjykata e Apelit, pasi e ka rënduar pozicionin e të pandehurit, nuk duhet ta kishte klasifikuar veprën sipas nenit 143§2 të Kodit Penal. I pandehuri ... duhet të shpallet fajtor dhe të dënohet mbi bazën e nenit 143 për veprën penale të mashtrimit për 57,923 akuza, të barabarta me numrin e personave të dëmtuar.

Gjykata e Lartë konsideron ankimin e të pandehurit se e drejta e tij për mbrojtje ishte shkelur nga ndryshimi i cilësimit të veprës penale nga Gjykata e Apelit, në kundërshtim me nenet 372, 376/1 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenin 31(a) të Kushtetues, si të pabazuar. Gjykata, duke i dhënë fakteve një përcaktim të ndryshëm, mund të ricilësojë veprën penale, e cila mund të jetë më pak e rëndë ose më e rëndë. Në këtë rast kjo nuk do të thotë se pozicioni i të pandehurit është rënduar. Në përputhje me nenin 375 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata mund t’i japë fakteve një përcaktim të ndryshëm nga ai i dhënë nga prokurori, meqë gjykata është e pavarur dhe kryen vlerësimin e saj të fakteve.

Në këtë kontekst, neni 375 nuk e detyron gjykatën t’i japë të pandehurit kohë në mbrojtje të interesit të tij, ndërsa sipas nenit 372, 373 dhe 374, të pandehurit i jepet kohë shtesë për të siguruar mbrojtjen e tij kundër akuzave të reja të paraqitura nga prokurori. Këto dispozita i referohen prokurorit, i cili përpara



përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, ka të drejtën për të ndryshuar akuzat, për të ngritur një akuzë të ndryshme ose për të akuzuar të pandehurin për një veprë të re penale. Në këto raste, për shkak se të drejtat e mbrojtjes duhet të sigurohen, ligji parashikon që gjykata t'i japë të pandehurit kohë për të siguruar mbrojtjen e tij kundër akuzave të reja. Në rastin e zbatimit të Nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale, kur gjykata procedon me një ricilësim të ndryshëm të veprës, e njëjta procedurë detyruese nuk zbatohet si në rastin e paraqitjes së akuzave të reja nga prokurori. Gjykata, pas një shqyrtimi të fakteve, mund t'i japë fakteve një përcaktim të ri dhe të ndryshëm ligjor. Ligji procedural penal nuk parashikon shtyrjen e seancave ose dhënien e një kohe [shtesë] për mbrojtjen, kur ricilësimi i veprës penale është bërë nga gjykata në bazë të vendimit të saj të formës së prerë. Në kundërshtim me ankimin e të pandehurit, nuk mund të thuhet se ka pasur shkelje të së drejtës për mbrojtje të të pandehurit.

Fryma e ligjit (neni 375 i Kodit të Procedurës Penale) ka qenë se, për shkak të ndryshimit të tij në bazë të ligjit nr. ..., ligjbërësi synoi të qartësonte përmbajtjen e tij. Sipas amendimit, ai deklaroi se “me anë të vendimit të formës së prerë, gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai i dhënë nga prokurori ose nga pala e dëmtuar, që mund të jetë më e favorshme ose më e rëndë, me kusht që të jetë kompetente *ratione personae* për të shqyrtuar veprën.”

Ankimi i të pandehurit se gjykatat nuk kishin marrë në pyetje të gjithë kreditorët e Vefas, është i pabazuar. Prokurori dhe gjykatat morën në pyetje aq kreditorë sa çmohej e nevojshme. Marrja në pyetje e kreditorëve nuk përbën nevojë ligjore meqë mashtrimi nuk është veprë penale që mund të ndiqet penalisht vetëm mbi bazën e një ankimi. Për më tepër, kjo marrje në pyetje nuk ishte e nevojshme, me qëllim që të qartësohej ose bazohej akuza kundër të pandehurit.

Ankimi i të pandehurit se zëvendësimi i prokurorit të apelit nga Prokurori i Përgjithshëm, në fazën e procedimeve të apelit para Gjykatës së Apelit, ishte në shkelje të nenit 27/1 të Kodit të Procedurës Penale, është i pabazuar. Rezulton se zëvendësimi i prokurorit të apelit nga Prokurori i Përgjithshëm ishte në përputhje me nenin 27 të Kodit të Procedurës Penale pasi sipas Prokurorit të Përgjithshëm, prokurori i apelit kishte shprehur opinionin e tij paraprak rreth çështjes.

Sa më sipër, Gjykata nxjerr përfundimin se i pandehuri duhet të shpallet fajtor për 57,923 akuza për veprën penale të mashtrimit, në përputhje me nenin 143 të Kodit Penal. Në miratimin e dënimit, gjykata merr në konsideratë rrezikshmërinë shoqërore të të pandehurit, numrin e madh të palëve të dëmtuara dhe sasinë e konsiderueshme të dëmit të shkaktuar dhe, ajo çmon se ankuesi duhet të dënohet me njëzet vjet burgim.”

4. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese i 3 dhjetorit 2004

63. Ankuesi paraqiti një apel kushtetues, duke u mbështetur në të njëjtat arsye apeli si para gjykatave më të ulëta.

64. Me një shkresë të datës 9 dhjetor 2004, ankuesi u informua se më 3 dhjetor 2004, Gjykata Kushtetuese, duke vepruar si një trup gjykues me tre gjykatës, kishte shpallur apelin e tij të papranueshëm për pamundësinë për të ngritur çështje në lidhje me një shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë.

E. Gjendja shëndetësore e ankuesit dhe procedimet e brendshme

65. Që prej arrestimit të tij më 28 prill 1998, gjendja shëndetësore e ankuesit ka qenë e paqëndrueshme.

66. Një vërtetim mjekësor i 11 gushtit 1998, nxori përfundimin se “edhe pas mjekimit intensiv të marrë çdo ditë gjendja vjen duke u rënduar”. Në disa raste ai kishte pasur probleme të rënda kardiake, të cilat kishin çuar në shtrimin e tij urgjent në spital.” Ankuesi ishte diagnostikuar me probleme kardiake dhe neuropsikiatrike.

67. Me kërkesë të përfaqësuesit të ankuesit, një raport tjetër mjekësor i 7 majit 1999, i përgatitur nga një komision prej tre mjekësh, nxori përfundimin se ankuesi “vuan nga tension i lartë arterial i paqëndrueshëm... kjo karakterizohet nga angjina (dhimbje kraharori), e cila ka qenë e shpeshtë, pothuajse e përditshme. Sëmundja e lidhur me të, duke marrë parasysh ekzistencën e një rreziku të mundshëm të papritur për jetën, ka nevojë për ndihmë dhe trajtim të vazhdueshëm kardiak mjekësor.” Raporti përcaktoi se kushtet e ndalimit të ankuesit kishin ndikim negativ në përparimin e sëmundjeve.

68. Nga data 2 dhjetor 1999 deri 24 dhjetor 2001, ankuesi ishte vendosur nën arrest shtëpie për shkak të gjendjes së tij shëndetësore. Ai vizitohej rregullisht nga mjekë të ndryshëm specialistë dhe gjendja e tij shëndetësore u stabilizua. Pas vendimit të Gjykatës së Apelit të 24 dhjetorit 2001 (shihni paragrafin 56 më lart), ankuesi u dërgua në burg për të vuajtur dënimin e tij.

69. Pas një kërkesë të bërë nga përfaqësuesi i tij ligjor më 26 mars 2002, u krye një vizitë mjekësore. Kjo vizitë konfirmoi se ankuesi vuante nga diabeti për pesë deri gjashtë vjet dhe, gjithashtu, vuante nga tensioni i lartë arterial i paqëndrueshëm, i shoqëruar me angjinë dhe infeksion urinar. Raporti



nxori përfundimin se “gjendja shëndetësore e ankuesit, në krahasim me vizitat e mëparshme të kryera midis periudhës 1998 dhe 2001, rezultoi të ketë ardhur duke u keqësuar.

70. Një shkresë e 2 dhjetorit 2005 nga drejtuesit e Burgut të Peqinit përshkruante hollësisht zhvillimin e gjendjes shëndetësore të ankuesit nga 16 qershori 2004 deri më 1 nëntor 2005. Ajo konfirmonte sëmundjet e ankuesit dhe shtonte se “këto sëmundje të ndërlidhura, duke marrë parasysh ekzistencën e një rreziku të mundshëm të papritur për jetën, kanë nevojë për ndihmë dhe trajtim të vazhdueshëm mjekësor.”

71. Një shkresë e 7 nëntorit 2006 nga drejtuesit e Burgut të Peqinit përshkruante hollësisht zhvillimin e gjendjes shëndetësore të ankuesit nga 1 janari 2006 deri më 31 tetor 2006. Ajo përcaktonte se “ndonjëherë ankuesi kishte probleme të rënda shëndetësore të cilat kishin ndodhur si rezultat i sëmundjeve të tij kronike. Nga 14 gushti 2006 deri 19 shtator 2006, ankuesi kishte probleme edhe më të rënda që i rrezikonin jetën.”

72. Më 11 prill 2007, ankuesi u transferua në Spitalin e Burgut të Tiranës (SBT) për trajtim mjekësor të specializuar. Ai qëndroi në SBT deri më 16 janar 2009. Dosja mjekësore e paraqitur nga Qeveria tregonte se ankuesi vizitohej çdo ditë nga mjekët e SBT-së, dhe vizitat shpeshtoheshin në ditë të caktuara. Raporti i lirim tregonte se gjendja shëndetësore e ankuesit ishte përmirësuar dhe stabilizuar. Ai përmbante një listë të medikamenteve që i ishin dhënë.

73. Një përmbledhje e diagnozës dhe trajtimit të ankuesit në SBT u bë me anë të shkresës të datës 27 janar 2010 nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Shkresa përcaktonte se, kur ishte shtruar në spital më 11 prill 2007, ankuesi kishte manifestuar simptomat e mëposhtme klinike: dhimbje kufizuese kraharori, probleme frymëmarrjeje, urinim të shpeshtë, etje të theksuar, dhimbje epigastrike dhe të përziera. Ankuesi ishte diagnostikuar më parë se vuante nga diabeti dhe tensioni i lartë arterial për përkatësisht 11 dhe 10 vjet. Ai kishte qenë duhanpirës për një kohë të gjatë.

74. Gjatë qëndrimit të tij në SBT ishin kryer vizitat e mëposhtme: analiza të rregullta gjaku, teste biokimike dhe të urinës, elektrokardiograma të shpeshta, ekokardiograma (EKO), ultratingull abdominal, radiografi mushkërisht, vizita sysh dhe

intubime. Ankuesi ishte trajtuar për angjinë, tension të lartë arterial, diabet, hiperplazi prostatike beninje dhe infeksion urinar. Atij i ishin dhënë nga SBT-ja me recetë medikamente të shumta ditore. Për më tepër, shkresa shtonte se ankuesi kishte blerë medikamente që i përkisnin një shoqërie tjetër farmaceutike, të ngjashme me ato të magazinuar në farmacinë e SBT-së.

75. Më 16 janar 2009, ankuesi ishte transferuar në burg. Dosja mjekësore tregonte se nga 27 janari 2009 deri më 14 janar 2010 ishte vizituar nga 23 mjekë. Në çdo rast ishte vërejtur një përshkrim i përparimit të tij, duke përfshirë trajtimin e dhënë nga mjeku.

76. Me një shkresë të 2 shkurtit 2010, autoritetet penitenciare deklaruan se ankuesi vazhdonte të merrte rregullisht trajtimin e dhënë me recetë. Ai ishte në gjendje të mirë shëndetësore dhe nuk kishte probleme që kishin nevojë për trajtim të specializuar. Ankuesi nuk kishte paraqitur ankime që pretendonin trajtim të pamjaftueshëm në bllokun e ankesave të burgut.

Procedimet e brendshme

a) Grupi i parë i procedimeve

77. Më 6 dhjetor 2006, ankuesi paraqiti një padi në Gjykatën e Rrethit që kërkonte lirim nga burgu sipas nenit 478 të Kodit të Procedurës Penale.

78. Më 4 maj 2007, Gjykata e Rrethit Elbasan vendosi pushimin e çështjes për shkak të mosparaqitjes së përfaqësuesit të ankuesit para gjykatës pa arsye bindëse.

b) Grupi i dytë i procedimeve

79. Në një datë të papërcaktuar në vitin 2007 procedimet rifilluan nga Gjykata e Rrethit pas një kërkese të re të depozituar nga ankuesi. Në një datë të papërcaktuar, Gjykata e Rrethit i kërkoi Institutit të Mjekësisë Ligjore të paraqiste një raport mjekoligjor për tri çështjet e mëposhtme: a) gjendja aktuale shëndetësore e ankuesit; b) nëse ankuesi vuante nga një sëmundje e rëndë e pashërueshme; dhe c) nëse sëmundja rrezikonte jetën edhe nëse ankuesi ishte shtruar në spital.

80. Më 27 shtator 2007, raporti mjekësor nxori përfundimin e mëposhtëm:

“gjendja shëndetësore [e ankuesit] është e paqëndrueshme. Ai vuan nga sëmundje zemre në nivel mesatar për shkak të pamjaftueshmërisë kardiace dhe tensioni i lartë i gjakut, si dhe diabet që trajtohej me insulinë. Sëmundja është kronike, dhe për shkak të moshës së madhe të ankuesit [58] dhe faktorëve të tjerë



rëndues, si për shembull pirja e duhanit dhe nivelet e yndyrës, ka nevojë për trajtim të kujdesshëm dhe të zgjatur mjekësor. Sëmundja nuk paraqet rrezik për jetën nëse ankuesi trajtohet rregullisht dhe në mënyrë të vazhdueshme në spital, duke përfshirë Qendrën Spitalore të Burgut.”

81. Më 15 nëntor 2007, Gjykata e Rrethit Elbasan rrëzoi ankimin e ankuesit. Ajo u mbështet në raportin mjekoligjor, duke konstatuar se gjendja e ankuesit mund të trajtohej në spital.

82. Më 3 qershor 2008 dhe 5 qershor 2009, përkatësisht Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë lanë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Elbasan. Asnjë kopje e vendimeve të gjykatave të apelit nuk iu dha Gjykatës.

c) Grupi i tretë i procedimeve

83. Në një datë të papërcaktuar në vitin 2008 ankuesi paraqiti një kërkesë tjetër për lirim nga burgu.

84. Më 8 tetor 2008, Gjykata e Rrethit Elbasan vendosi të shpallte çështjen jashtë juridiksionit të saj pasi ankuesi ishte transferuar në SBT në Tiranë, më 24 prill 2007. Rrjedhimisht, ajo e transferoi çështjen për shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

85. Më 2 dhjetor 2008, Gjykata e Rrethit Tiranë vendosi pushimin e çështjes për shkak të mosparaqitjes së përfaqësuesit të ankuesit pa arsye bindëse.

F. Publikimi në shtyp i kushteve në burgje në SBT

86. Më 4 qershor 2007 e përditshmja “Korrieri” raportoi se SBT-ja kishte arritur kapacitetin e tij maksimal dhe ishte me pajisje të pamjaftueshme. SBT-ja ofronte vetëm medikamentet bazë ndërsa medikamentet “më të kushtueshme” duhet të siguroheshin nga vetë të burgosurit ose familjet e tyre.

87. Më 10 dhjetor 2007 e përditshmja “Panorama” përmendi rezultatet e një vizite nga Zyra e Avokatit të Popullit në SBT (shihni “Raporti vjetor i vitit 2007 i Avokatit Shqiptar të Popullit”, më poshtë). Në artikull është vërejtur se SBT-ja ishte i mbipopulluar dhe i mungonin pajisje, hapësirë dhe medikamente të mjaftueshme.

G. Zhvillime të tjera në lidhje me burgimin e ankuesit

88. Në bazë të ligjit të amnistisë të 16 majit 2002, dënimi i ankuesit ishte ulur me tre vjet, dhjetë muaj e nëntë ditë.

89. Në vitet 2003, 2004 dhe 2005, dënimi i ankuesit ishte ulur me një muaj e njëzet e tetë ditë për shkak të punës së tij në burg.

90. Më 7 prill 2005 dhe më 8 qershor 2006, Gjykata e Rrethit Elbasan vendosi të ulte dënimin e ankuesit me gjashtë muaj.

91. Më 2 shkurt 2007, dënimi i mbetur i ankuesit ishte gjashtë vjet.

92. Në një datë të papërcaktuar ankuesi paraqiti një kërkesë në Gjykatën e Rrethit Elbasan për të përfutur nga dispozitat e ligjit të amnistisë që kishte hyrë në fuqi më 2 shkurt 2007.

93. Më 19 mars 2009, Gjykata e Rrethit Elbasan, në mbështetje të ligjit të amnistisë, vendosi të ulte dënimin e mbetur të ankuesit me një vit e gjashtë muaj, me fuqi nga 2 shkurti 2007. Vendimi mori formë të prerë më 14 janar 2010.

94. Më 22 prill 2010, dënimi i mbetur i ankuesit ishte ulur me një vit mbi bazën e një faljeje nga Presidenti.

95. Më 15 korrik 2011, Qeveria informoi Gjykatën se ankuesi kishte vuajtur plotësisht pjesën e mbetur të dënimit të tij dhe ishte liruar më 3 maj 2010.

II. LIGJI DHE PRAKTIKA E BRENDSHME PËRKATËSE

A. Kushtetuta e Shqipërisë

96. Kushtetuta e Shqipërisë hyri në fuqi më 28 nëntor 1998. Dispozitat e saj përkatëse parashikojnë si më poshtë:

Neni 27§3

“Askujt nuk mund t’i hiqet liria vetëm për shkak se nuk është në gjendje të përmbushë një detyrim kontraktor.”

Neni 29§2

“Nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale.”

Neni 31

“Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë:

a) të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t’i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij;

b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;

c) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe;

ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe



privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme;

d) t'u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet”.

Neni 131

“Gjykata Kushtetuese vendos për:

f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.”

Neni 134§§1(f) dhe 2

“1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje vetëm me kërkesë të:

...

f) partive politike dhe organizatave të tjera;

g) individëve.

2. Subjektet e parashikuara nga paragrafi i parë, shkronjat ... (f) dhe (g), mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.”

B. Kodi Civil

97. Neni 1050 parashikon:

“Një hua është një kontratë me anë të së cilës njëra palë (huadhënësi) i jep në pronësi palës tjetër (huamarrësit) një shumë të hollash ose sende që përcaktohen në numër, me peshë ose me masë dhe huamarrësi detyrohet t'i kthejë huadhënësit aq të holla, ose aq sende të atij lloji dhe të asaj cilësie, brenda afatit të caktuar në kontratë ose, kur nuk është caktuar afat, me kërkesën e huadhënësit”.

C. Kodi Penal (KP)

98. Kodi Penal hyri në fuqi më 1 qershor 1995. Dispozitat e mëposhtme që ishin në fuqi në atë kohë, lidhen me çështjen në fjalë:

Neni 2 – Mosdënimi pa ligj

“Askush nuk mund të dënohet penalisht për një vepër që më parë nuk është e parashikuar shprehimisht në ligj si krim ose kundërvajtje penale.

Askush nuk mund të dënohet me një lloj dhe masë dënimi të paparashikuar në ligj”.

Neni 29 – Dënimet kryesore

Për personat që kanë kryer krime jepen këto dënime kryesore:

1. Me burgim të përjetshëm ose vdekje

2. Me burgim

3. Me gjobë

...

Neni 32 – Dënimi me burgim

Dënimi me burgim për krime jepet për një kohë nga pesë ditë deri në njëzet e pesë vjet.

Për kundërvajtje penale dënimi me burgim jepet për një kohë nga pesë ditë deri në dy vjet.

Neni 50 – Rrethanat rënduese

Sa më poshtë konsiderohen rrethana rënduese:

a) kryerja e veprës i shtyrë nga motive të dobëta;

b) kryerja e veprës për të vënë para përgjegjësisë ose për të fshehur përgjegjësinë penale të një tjetri apo për të shmangur dënimin për një vepër tjetër penale;

c) kryerja e veprës penale me egërsi dhe mizori;

ç) kryerja e një krimi pas dhënies së një dënimi për një krim të kryer më parë;

dh) kryerja e veprës penale duke shpërdoruar funksionin publik ose shërbimin fetar;

e) kur vepra është kryer kundër fëmijëve, grave shtatzëna ose personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen;

f) kur vepra është drejtuar ndaj përfaqësuesve të shteteve të tjera;

g) kur vepra është kryer duke përfutur nga marrëdhëniet familjare, të miqësisë, të mikpritjes;

gj) kryerja e veprës penale në bashkëpunim;

99. Ligji nr. 8733 i 24 janarit 2001, shtoi rrethanën e mëposhtme rënduese:

“kryerja e një krimi si vepër e përsëritur.”

Neni 55 – Caktimi i dënimeve për disa vepra penale

“Kur veprimet ose mosveprimet përmbajnë elementët e disa veprave penale, si dhe kur personi ka kryer disa vepra penale për të cilat nuk është dhënë akoma vendim, gjykata më parë cakton dënimin për çdo vepër penale dhe në përfundim jep një dënim të vetëm, që përbëhet nga dënimi më i rëndë i shtuar. Dënimi më i rëndë i shtuar nuk mund të kapërcejë shumën e përgjithshme të dënimeve të caktuara veç e veç, as kufirin më të lartë të parashikuar për llojin e dënimit të dhënë.

...”

a) Komentari mbi Kodin Penal

100. Komentari i vitit 1999 mbi Kodin Penal (shihni *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë* nga Prof. I. Elezi, Dr. S. Kaçupi dhe Dr. M. Haxhia) parashikon si më poshtë mbi subjektin e interpretimit të nenit 55:

“Neni 55 parashtron dispozita të posaçme për caktimin e dënimit kur një person, me anë të veprimeve ose mosveprimeve, ka kryer dy ose më shumë vepra penale në të njëjtën kohë ose në kohë të ndryshme, përpara miratimit të një vendimi gjykate në lidhje me ndonjë prej veprave penale [të lartpërmendura].



Rregulli i parashtruar për caktimin e dënimeve është se gjykata cakton një dënim [të veçantë] për çdo veprë penale të kryer nga i pandehuri dhe në fund vendos një bashkim dënimesh brenda afateve të parashikuara nga dispozitat e së drejtës penale, duke marrë në konsideratë rrezikshmërinë shoqërore të autorit dhe çdo rrethanë lehtësuese ose rënduese. Kushtet për vendosjen e një bashkimi dënimesh janë si më poshtë.

a) Duhet të jenë kryer dy ose më shumë vepra penale të parashikuara nga dispozita të ndryshme të Kodit [Penal]. Asnjë prej veprave nuk mund të parashkruhet ose t'i jetë nënshtruar amnistisë ose procedimeve që ishin pushuar. Për shembull, një bashkim dënimesh vendoset kur i pandehuri ka kryer vrasje me dashje me anë të armëmbajtjes pa leje. Në caktimin e dënimit, gjykata cakton dënimin për veprën penale të vrasjes me dashje dhe më pas dënimin për veprën penale të armëmbajtjes pa leje. Gjkata atëherë vendos një dënim të vetëm, jo mbi bazën e shtesës aritmetike por duke vendosur dënimin më të lartë kumulativ. Më konkretisht, gjykata cakton dënim me pesëmbëdhjetë vjet burgim për veprën penale të vrasjes me dashje dhe burgim me pesë vjet për veprën penale të armëmbajtjes pa leje. Duke aplikuar bashkim dënimesh, gjykata cakton një dënim me tetëmbëdhjetë vjet burgim, i cili i korrespondon dënimit më të lartë kumulativ. Kjo do të thotë se tre vjet iu shtuan dënimit më të lartë prej pesëmbëdhjetë vjet burgim, duke çuar në dënimin më të lartë kumulativ prej tetëmbëdhjetë vjet burgim.

...

Një bashkim dënimesh nuk mund të caktohet kur të njëjtat veprime, të kryera në mënyrë të përsëritur, përbëjnë pjesë të një veprë të vetme sipas Kodit [Penal]. Për shembull, plagosja e rëndë e shkaktuar ndaj disa personave, pavarësisht nga fakti se ishte shkaktuar në mënyrë të vazhdueshme dhe me anë të të njëjtat veprime kundër dy, tre ose më shumë personave, përbën pjesë të një veprë të vetme posaçërisht të parashikuar sipas nenit... dhe nuk mund t'i nënshtrohet një bashkimi dënimesh.

b) Kushti tjetër për caktimin e një bashkimi dënimesh është se asnjë vendim gjykate nuk duhet të ishte marrë në lidhje me ndonjë prej veprave. Gjykimi dhe dënimi duhet të zhvillohen në të njëjtën kohë në lidhje me të gjitha veprat. ...

...

Paragrafi i dytë i nenit 55 parashikon se dënimi më i lartë kumulativ nuk duhet të tejkalojë as sasinë e përgjithshme të dënimeve të caktuara veçmas, as dënimin maksimal brenda tipit të dënimit të vendosur.

...

Për shembull, Gjykata e Rrethit Tiranë dënoi L. për veprën penale të plagosjes së rëndë me dashje me pesë vjet burgim dhe për veprën penale të armëmbajtjes pa

leje me tre vjet burgim. Ajo caktoi përfundimisht ndaj tij një bashkim dënimesh prej shtatë vjet burgim. Në këtë rast, dënimi më i lartë kumulativ u zbatua drejt për faktin se dënimi nuk tejkalonte sasinë e përgjithshme të dënimeve të veçanta të vendosura (tetë vjet), ose dënimin maksimal brenda tipit të dënimit të caktuar, d.m.th., burgim.

Në një rast tjetër, Gjykata e Lartë deklaroi si më poshtë: “V. ka kryer veprën penale të marrëdhënies seksuale me të mitur dhe atë të plagosjes së rëndë dhe me dashje të viktimit. Për veprën e parë, ai do të dënohet me pesëmbëdhjetë vjet burgim dhe për të dytën me dhjetë vjet burgim. Me bashkim dënimesh ai do të dënohet me njëzet e dy vjet burgim.” Edhe në këtë rast, ligji u zbatua drejt ndërsa gjykata vendosi veprën penale më të rëndë kumulative pa tejkaluar masën maksimale të burgimit, që është njëzet e pesë vjet.

b) Praktika e Gjykatës së Lartë mbi zbatimin e nenit 55 të Kodit Penal

101. Në tri vendime (nr. 607 të 6 nëntorit 2002, nr. 295 të 28 marsit 2001 dhe nr. 403 të 13 qershorit 2001), Gjykata e Lartë la në fuqi vendimet e Gjykatës së Apelit, duke zbatuar nenin 55 për bashkimin e dënimeve ndaj të pandehurve për veprat penale të vrasjes dhe armëmbajtjes pa leje.

102. Në dy vendime (nr. 566 i 23 tetorit 2002 dhe nr. 207 i 28 marsit 2002), Gjykata e Lartë la në fuqi vendimet e gjykatave më të ulëta, duke zbatuar nenin 55 në caktimin e bashkimit të dënimeve ndaj të pandehurve në lidhje me krimet e vrasjes me paramendim dhe armëmbajtjes pa leje.

103. Në vendimin nr. 457 të 23 korrikut 2002, Gjykata e Lartë la në fuqi një vendim të Gjykatës së Apelit, duke zbatuar nenin 55 në caktimin e një bashkimi dënimesh ndaj të pandehurit në lidhje me veprat penale të vjedhjes, armëmbajtjes pa leje dhe shkatërrimit të qëllimshëm të pronës.

104. Në vendimin nr. 453 të 17 korrikut 2002, Gjykata e Lartë, në shpalljen e të pandehurit fajtor për plagosje të rëndë me dashje dhe armëmbajtje pa leje, zbatoi nenin 55 në caktimin e një bashkimi dënimesh.

105. Në vendimin nr. 197 të 21 marsit 2002, Gjykata e Lartë, në dënimin e të pandehurit për vrasje për shkak të cilësive të veçanta të viktimit dhe armëmbajtjes pa leje, zbatoi nenin 55 në caktimin e një bashkimi dënimesh.

106. Në vendimin nr. 50 të 23 janarit 2002, Gjykata e Lartë la në fuqi një vendim të Gjykatës së Apelit që kishte zbatuar nenin 55 për caktimin e një bashkimi dënimesh ndaj një prej të pandehurve në



lidhje me veprat penale të prodhimit të monedhës së falsifikuar dhe prodhimit të mjeteve për falsifikim.

107. Në vendimin nr. 435 të 13 qershorit 2001, Gjykata e Lartë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit, duke zbatuar nenin 55 në caktimin e një bashkimi dënimesh ndaj një prej të pandehurve në lidhje me krimet e vrasjes, vrasjes së mbetur në tentativë dhe armëmbajtjes pa leje.

108. Në vendimin nr. 319 të 30 majit 2001, Gjykata e Lartë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit, duke zbatuar nenin 55 në caktimin e një bashkimi dënimesh ndaj të pandehurit në lidhje me veprat penale të vrasjes me paramendim të mbetur në tentativë dhe armëmbajtjes pa leje.

109. Në vendimin nr. 307 të 23 majit 2001, Gjykata e Rrethit la në fuqi një vendim të Gjykatës së Apelit që kishte zbatuar nenin 55 në dënimin e të pandehurit në lidhje me veprat penale të kërcënimit dhe armëmbajtjes pa leje.

110. Në vendimin nr. 227 të 18 prillit 2001, Gjykata e Lartë, në shpalljen e të pandehurit fajtor për armëmbajtje pa leje dhe vrasje të kryer në gjendjes të tronditjes së fortë psikike, zbatoi nenin 55 në caktimin e një bashkimi dënimesh.

111. Në vendimin nr. 85 të 1 shkurtit 2001, Gjykata e Lartë la në fuqi vendimet e gjykatave më të ulëta, duke zbatuar nenin 55 në caktimin e një bashkimi dënimesh në lidhje me veprat penale të vrasjes me dashje të mbetur në tentativë dhe armëmbajtjes pa leje.

112. Në vendimin nr. 39 të 18 janarit 2001, Gjykata e Lartë la në fuqi një vendim të Gjykatës së Apelit, duke zbatuar nenin 55 në caktimin e një bashkimi dënimesh ndaj një të pandehuri në lidhje me veprat penale të vjedhjes së armatosur të kryer në bashkëpunim me të tjerë, vjedhja e pasurisë me pasojë vdekjen dhe armëmbajtje pa leje.

Neni 143 – Mashtrimi

“[1.] Vjedhja e pasurisë me anë të gëneshtrës ose shpërdorimit të besimit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.”

113. Paragrafi i mëposhtëm iu shtua nenit 143 me ligjin nr. 8733 të 24 janarit 2001.

“[2.] Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet dhe, kur ka sjellë pasoja të rënda, me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.”

Vendimi nr. 284 i 15 shtatorit 2000 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

114. Në përpjekje për të harmonizuar praktikën ligjore, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosën më 15 shtator 2000 se një person i cili kishte kryer veprën penale të mashtrimit, siç përcaktohet në nenin 143 të Kodit Penal, duhet të dënohet për aq akuza sa numri i palëve të dëmtuara.

Neni 143/a – Skemat piramidale dhe mashtruese

Neni 143/a, i cili hyri në fuqi në bazë të ligjit nr. 8733 të 24 janarit 2001, parashikon si më poshtë:

“Organizimi dhe vënia në funksionim e skemave mashtruese dhe piramidale të huamarrjes, me qëllim fitimi material, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

D. Kodi i Procedurës Penale (KPP)

115. Dispozitat e mëposhtme të KPP-së lidhen me çështjen në fjalë:

Neni 290

Procedimi penal nuk mund të fillojë dhe, në qoftë se ka filluar, duhet të pushojë në çdo fazë të procedimit, kur:

...

e) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 432

“Rekursi në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të gjykatës së apelit mund të bëhet për këto shkaqe:

a) për mosrespektimin ose për zbatimin e gabuar të së drejtës penale;

b) për shkelje që kanë si pasojë pavlefshmërinë e vendimit të gjykatës, sipas nenit 128 të këtij Kodi;

c) për shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit.

116. Neni 434 parashikon se Gjykata e Lartë do të shqyrtojë një apel në masën që çështjet ligjore janë ngritur në të.

Neni 478

“Gjykata e vendit të ekzekutimit mund të vendosë lirimin e të burgosurit kur vazhdimi i burgimit mund të rrezikojë jetën e tij.

E. Ligji për ndalimin e skemave piramidale (ligji për ndalimin e skemave piramidale të huamarrjes, ligji nr. 8188 i datës 23 janar 1997)

117. Ligji parashikonte se huamarrja e organizuar mbi bazën e skemave mashtruese



piramidale, ishte e paligjshme. Krijimi dhe vënia në funksionim e skemave piramidale të huamarrjes përbënte vepër penale që dënohej me jo më pak se njëzet vjet burgim dhe konfiskim të pasurisë të luajtshme dhe të paluajtshme.

F. Ligji për auditimin e subjekteve jobankare (ligji për auditimin e subjekteve jobankare që kanë marrë hua nga qytetarët, ligji nr. 8215 i datës 9 maj 1997 (ligji nr. 1), i ndryshuar me ligjin nr. 8227 të 30 korrikut 1997 (ligji nr. 2); ligji nr. 8347 i 18 majit 1998, (ligji nr. 3)

a) Ligji nr. 1

118. Ligji parashikonte se të gjitha subjektet jobankare do t'i nënshtroheshin një kontrolli financiar në lidhje me gjendjen e tyre financiare, numrin e kreditorëve, aktivëve dhe pasivëve të tyre dhe depozitave të tyre të brendshme dhe të jashtme, nga një grup ekspertësh financiarë të caktuar nga Qeveria (seksioni 1).

119. Grupi Mbikëqyrës i përbërë nga tre anëtarë u krijua për monitorimin e të gjithë procesit (seksioni 2). Grupi Mbikëqyrës bashkërendoi aktivitetet midis ekspertëve dhe subjekteve që i nënshtrohen ligjit (seksioni 3).

120. Ekspertët financiarë duhet të shqyrtonin regjistrat e arkës të shoqërive, kontratat e lidhura me kreditorët dhe çdo dokument tjetër përkatës (seksioni 4).

b) Ligji nr. 2

121. Seksioni 3 parashikonte si më poshtë: “Prokurori dhe gjykata nuk fillojnë procedura hetimore ose nuk kryejnë gjykime penale nëse dhe derisa procesi i administrimit në lidhje me subjektin [jobankar] ose personin e lidhur me të, nuk ka përfunduar.”

c) Ligji nr. 3

122. Seksioni 1 e la të hapur fillimin e procedimeve penale kundër subjektit jobankar ose personit të lidhur me të dhe ndryshoi seksionin 3 të ligjit nr. 2 me tekstin e mëposhtëm “në masën që procesi i administrimit në lidhje me subjektin jobankar ose personin e lidhur me të nuk ka përfunduar, organet gjyqësore nuk shqyrtojnë procedime civile ose tregtare...”

G. Raportet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Dënimet Degradues ose Çnjerëzor (KPT)

123. KPT-ja vizitoi Shqipërinë në vitin 2006. Konkluzionet përkatëse të raportit të tij KPT/Inf

(2007) 35, që u publikuan më 6 shtator 2007, janë si më poshtë:

“27. ... KPT-ja ngriti çështjen e vonesave të gjata të cilat ishin vërejtur nga delegacioni, veçanërisht në Durrës, në lidhje me transferimin e të burgosurve, të cilët kishin nevojë urgjente shtrimi në spital. Vizita e vitit 2006 tregoi se ky problem nuk ishte zgjidhur ende. Delegacioni u informua se spitalet e përgjithshme nuk ishin të gatshme të pranoinin të ndaluar nga qendrat e paraburgimit për shkak të faktorëve të sigurisë ndërsa transferimet në Spitalin e Burgut në Tiranë, sipas raporteve, ishin të vështira pasi Spitali i Burgut ishte nën autoritetin e Ministrisë së Drejtësisë.

Në Durrës, delegacioni u informua nga mjeku se nuk kishte kërkuar transferime të të ndaluarve në Spitalin e Burgut për një kohë të gjatë meqë disa kërkesa ishin refuzuar nga Spitali i Burgut më 2004-n. E gjithë çështja u ngrit më pas gjatë konsultimeve me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme. Me këtë rast, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë i konfirmuan delegacionit se, si rregull, të gjitha kërkesat për transferime të të ndaluarve të sëmure nga qendrat e paraburgimit në Spitalin e Burgut, ishin pranuar pavarësisht nga fakti se spitali ishte shpesh i mbipopulluar. Në masën që delegacioni mund të konstatojë, ka një mungesë të vazhdueshme komunikimi dhe bashkërendimi midis dy ministrive përkatëse.”

H. Raporti vjetor i Avokatit të Popullit i vitit 2007

124. Raporti vjetor i referohet një vizite inspektimi të kryer në SBT, në vitin 2007. Konkluzionet përkatëse të raportit janë si më poshtë:

“Rezulton se SBT-ja ka funksion vetëm kurativ, i cili përfshin dhënien e medikamenteve për pacientët. Ai nuk mund të diagnostikojë sëmundje.

Ky spital ka karakteristikat e një burgu të mirëfilltë dhe nuk përmbush standardet minimale të një shërbimi spitalor. Nuk ka sallë urgjence, ambiente radiografie etj. Në të gjitha rastet, pacientët e shoqëruar nga mjeku i burgut, transferohen në spitale të tjera civile. Sa herë që ndodh kjo, mjekët [civilë] nuk janë të gatshëm të vizitojnë pacientët, duke i poshtëruar ata me qëndrimin e tyre dhe duke i lënë të presin për një kohë të gjatë.”

LIGJI

I. SHKELJA E PRETENDUAR E NENEVE 2 DHE 3 TË KONVENTËS

125. Ankuesi u ankua sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës se trajtimi mjekësor që pretendohet se



ishte i pamjaftueshëm, i dhënë atij ndërsa vuante dënimin, kishte rrezikuar të drejtën e tij për jetën. Dispozitat e lartpërmendura janë si më poshtë:

Neni 2

“1. E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj.

2. Marrja e jetës nuk konsiderohet të shkaktohet në kundërshtim me këtë nen në rastet kur ajo vjen si pasojë e përdorimit të forcës, që është jo më shumë se absolutisht e nevojshme:

- a) në mbrojtje të çdo personi nga dhuna e paligjshme;
- b) për të kryer një arrestim të ligjshëm ose për të parandaluar arratisjen e një personi të cilit i është hequr liria ligjërisht;
- c) për të kundërshtuar, në përputhje me ligjin, një trazirë ose kryengritje.”

Neni 3

“Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.”

A. Parashtrimet e palëve

126. Qeveria parashtroi se faktet e çështjes nuk shkaktonin shkelje të nenit 2 të Konventës. Ato lidheshin me mjaftueshmërinë e ndihmës mjekësore të dhënë ankuesit ndërsa ishte në burg, që duhet të shqyrtohej sipas nenit 3 të Konventës.

127. Sipas pikëpamjes së tyre, ankuesi nuk kishte shteruar mjetet e brendshme ligjore. Ai nuk kishte paraqitur ankesë të brendshme pranë autoriteteve administrative, në përputhje me seksionin 49 të ligjit për të Drejtat e të Burgosurve në lidhje ose me paaftësinë e autoriteteve për ta trajtuar atë, ose me ndihmën e pamjaftueshme mjekësore të dhënë atij. Ai nuk kishte paraqitur ankime mbi mungesën e medikamenteve për trajtimin e problemeve të tij shëndetësore. Për më tepër, kërkuesi nuk kishte shfrytëzuar mjetet e brendshme ligjore në lidhje me ankimin e tij.

128. Sipas pikëpamjes së Qeverisë, nëse ankuesi do të ishte keqtrajtuar, ai duhet të kishte kallëzuar tek autoritetet kompetente krimin dhe identitetin e autorëve të tij, me qëllim fillimin e një hetimi. E drejta penale shqiptare përcakton dënimet për veprën penale të keqtrajtimit dhe dënimet përkatëse të parashikuara. Në çdo rast, Qeveria pohoi se ankuesi kishte pasur akses për trajtim dhe

kujdes mjekësor. Për më tepër, ai ishte diagnostikuar me probleme neuropsikiatrike, si rezultat i të cilave ishte vendosur nën arrest shtëpie nga data 2 dhjetor 1999 deri më 24 dhjetor 2001. Kur gjendja e tij shëndetësore ishte stabilizuar, ankuesi ishte transferuar në burg me anë të një vendimi gjyqësor. Ankuesi ishte shtruar disa herë në Spitalin e Burgut, Tiranë. Për shembull, me rekomandim të mjekut ankuesi kishte qëndruar në Spitalin e Burgut, Tiranë, nga data 11 prill 2007 deri më 16 janar 2009.

129. Ankuesi pohoi se paaftësia e autoriteteve për t'i dhënë atij ndihmë të mjaftueshme mjekësore kishte qenë në shkelje të nenit 3 të Konventës.

B. Vlerësimi i Gjykatës

130. Gjykata rikujton se paaftësia e autoriteteve për të monitoruar gjendjen e një të ndaluarit ose për t'i ofruar një të ndaluarit kujdes mjekësor në një situatë e cila rrezikon jetën, mund të çojë në shkelje të nenit 2 (shihni *Douglas-Williams kundër Mbretërisë së Bashkuar* (dhjetor.), nr. 56413/00, 8 janar 2002). Megjithatë, në çështjen në fjalë, Gjykata vëren se parashtrimet e ankuesit dhe faktet e çështjes kanë më tepër lidhje me pamjaftueshmërinë e pretenduar të trajtimit mjekësor dhe rrjedhimisht, duhet të shqyrtohen sipas nenit 3 të Konventës. Gjykata do të procedojë në përputhje me rrethanat.

131. Gjykata çmon se në rrethanat e çështjes, nuk kërkohet që të trajtohet argumenti i mosshërimit të mjeteve ligjore të Qeverisë. Ankimi i ankuesit për nenin 3 është në çdo rast i papranueshëm për arsyet e mëposhtme.

132. Nga një fazë e hershme e paraburgimit të tij, ankuesi ishte shtruar në spital për shkak të problemeve shëndetësore (shihni paragrafin 66 më lart). Për më tepër, duke marrë parasysh gjendjen e tij të rënduar shëndetësore, autoritetet urdhëruan që ai të vendosej nën arrest shtëpie nga data 2 dhjetor 1999 deri më 24 dhjetor 2001. Ndërsa ankuesi paraqiti raporte të ndryshme mjekësore që dokumentonin përparimin e sëmundjes së tij kronike për periudhën nga 11 gushti 1998 deri më 7 nëntor 2006, ata kryesisht ia atribuuan përkeqësimin e gjendjes së tij shëndetësore ekzistencës dhe vazhdimit të këtyre sëmundjeve. Raportet mjekësore nuk tregonin elementë të paaftësisë së autoriteteve për të ofruar trajtim të mjaftueshëm mjekësor. Ankuesi nuk e argumentoi ankimin e tij që ai ishte privuar nga ndihma e



mjaftueshme dhe e vazhdueshme mjekësore.

133. Për më tepër, më 11 prill 2007 ankuesi ishte dërguar në SBT, ku iu nënshtrua disa testeve, duke përfshirë analiza të rregullta gjaku, testet biokimike dhe të urinës dhe EKO të shpeshta, radiografi dhe ultratinguj. Dosja mjekësore tregon se ankuesi ishte nën mbikëqyrjen e përditshme të mjekut, duke u vizituar ndonjëherë nga një mjek edhe dy herë në ditë, nga data 11 prill 2007 deri më 16 janar 2009. Ai u trajtua për angjinë, tension të lartë arterial, diabet, hiperplazi prostatike beninje dhe infeksion urinar.

134. Për më tepër, ankuesi nuk ishte ankuar në nivel të brendshëm rreth mjaftueshmërisë së trajtimit që ai mori nga data 11 prill 2007 deri më 16 janar 2009. Atij iu dha trajtim mjekësor me recetë nga rezervat farmaceutike të SBT-së. Nuk kishte asnjë të dhënë se ankuesi duhet të paguante për të. Fakti se ai dëshironte të blinte medikamente të prodhuara nga një shoqëri e veçantë farmaceutike nuk tregon se medikamente të ngjashme ose të paktën të mjaftueshme nuk i ishin vënë në dispozicion nga rezervat farmaceutike të SBT-së (shihni Aleksanyan kundër Rusisë, nr. 46468/06, §148, 22 dhjetor 2008). Artikujt dhe raportet e gazetave nga organet kombëtare të paraqitura nga ankuesi rreth kushteve dhe mungesës së trajtimit në SBT, gjithashtu, nuk tregojnë se ai, në fakt ishte trajtuar në nivel të pamjaftueshëm.

135. Më 16 janar 2009, ankuesi u transferua në burg. Nga ajo datë deri më 10 janar 2010, ai ishte nën mbikëqyrje të rregullt mjekësore. Përparimi i tij u regjistrua në dosjen mjekësore dhe iu dha trajtimi që ishte parashikuar për të. Gjendja e tij shëndetësore mbeti e qëndrueshme dhe nuk kishte të dhëna ose në fakt parashtrime nga ankuesi se gjendja e tij kishte nevojë për trajtim i cili nuk ishte ofruar.

136. Sa më sipër, Gjykata çmon se nuk ka të dhëna që tregojnë se autoritetet nuk mundën të siguronin trajtim të mjaftueshëm mjekësor për sëmundjet e diagnostikuara. Si rrjedhojë, gjykata nxjerr përfundimin se ankimi i ankuesit është haptazi i pabazuar dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35§§3 dhe 4 të Konventës.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 5 TË KONVENTËS

137. Ankuesi u ankua se paraburgimi i tij fillestar nuk ishte bazuar në një dyshim të

arsyeshëm dhe ishte në shkelje të nenit 5§1 të Konventës parashikon si më poshtë:

“1.Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:

...

c) kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent pas dyshimit të arsyeshëm se ka kryer një veprë penale ose kur çmohet në mënyrë të arsyeshme e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;

...”

138. Ankuesi u ankua më tej se kohëzgjatja e paraburgimit të tij kishte qenë në shkelje të nenit 5§3 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

“3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni duhet të çohet menjëherë përpara një gjyqtari ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në gjykim e sipër. Lirimi mund të kushtëzohet nga garanci për t'u paraqitur para gjykatës.”

139. Gjykata rithekson se “ajo mund të trajtojë një çështje ... brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga data në të cilën është marrë vendimi i formës së prerë” (shihni *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar* (dhjetor), nr. 46477/99, 7 qershor 2001).

140. Duke iu kthyer fakteve të çështjes në fjalë, Gjykata vëren se ankuesi e kundërshtoi ndalimin e tij fillestar të 28 prillit 1998 para gjykatave të brendshme. Edhe duke supozuar se vendimi i formës së prerë në lidhje me këto procedime ishte vendimi i Gjykatës Kushtetuese i 9 marsit 1999, ankuesi paraqiti ankimin e tij pranë Gjykatës më 2 qershor 2005. Rezulton se ky ankim ishte paraqitur jashtë afatit dhe duhet të kundërshtohet në përputhje me nenin 35§§1 dhe 4 të Konventës.

141. Në lidhje me ankimet e ankuesit mbi kohëzgjatjen e ndalimit të tij sipas nenit 5§3, Gjykata rithekson se paraburgimi përfundon për qëllimet e Konventës, me shpalljen e fajësisë dhe dënimit të caktuar në shkallën e parë (shihni *Caka kundër Shqipërisë*, nr. 44023/02, §68, 8 dhjetor 2009).

142. Në çështjen në fjalë Gjykata vëren se paraburgimi i ankuesit zgjati deri më 31 maj 2000, datë në të cilën Gjykata e Rrethit Tiranë, dha vendimin e saj që dënonte ankuesin. Pas asaj date, ndalimi i ankuesit u bazua në nenin 5§1(a) të



Konventës. Gjykata çmon se ankuesi duhet të kishte paraqitur ankimin e tij sipas nenit 5§3 brenda gjashtë muajve nga ajo datë. Ankimi i ankuesit ishte paraqitur pranë kësaj Gjykate më 2 qershor 2005, më shumë se gjashtë muaj pas vendimit të Gjykatës së Rrethit, Tiranë. Rezulton se ky ankim duhet të kundërshtohet në përputhje me nenin 35§§1 dhe 4 të Konventës.

III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 7 TË KONVENTËS

143. Ankuesi u ankua se ai ishte dënuar me një dënim më të lartë sesa ai i parashikuar nga ligji i brendshëm në atë kohë, në shkelje të nenit 7 të Konventës. Më tej, ai u ankua se duke marrë në konsideratë natyrën e ligjshme të aktivitetit të tij të huamarrjes, nuk duhet të fillonte asnjë ndjekje penale kundër tij.

Neni 7 i Konventës parashikon si më poshtë.

“1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim që, në momentin kur është kryer, nuk përbënte veprë penale sipas së drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale.

2. Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi për një veprim ose mosveprim, i cili, në momentin kur është kryer, quhej veprë penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara.”

A. Pranueshmëria

144. Gjykata vëren se ky ankim nuk është haptazi i pabazuar brenda kuptimit të nenit 35§3 të Konventës. Më tej, ajo vëren se ai nuk është i papranueshëm për arsye të tjera. Rrjedhimisht, duhet të shpallet i pranueshëm.

B. Themeli

1. Parashkrimet e palëve

145. Ankuesi pohoi se Gjykata e Lartë e rëndoi pozicionin e saj, duke caktuar një dënim më të lartë sesa ai i zbatueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale. Ai, gjithashtu, parashitroi se meqë ishte përfshirë në aktivitete të ligjshme të huamarrjes, ai nuk duhet t'i ishte nënshtruar ndjekjes penale.

146. Qeveria parashitroi se dispozitat e së drejtës penale ishin të aksesueshme dhe të parashikueshme. Ato kishin hyrë në fuqi përpara kryerjes së veprës penale nga ankuesi. Ato ishin publikuar në Fletoren Zyrtare dhe ankuesi për rrjedhojë kishte qenë në gjendje të parashikonte pasojat e veprimeve të tij.

147. Sipas pikëpamjes së Qeverisë, aktiviteti kriminal i ankuesit përfshinte disa vepra penale, d.m.th., 57,923 veprime të paligjshme që përfshinin një periudhë të gjatë kohe. Dënimi i ankuesit kishte qenë në përputhje me një vendim unifikues të vitit 2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Gjykata e Lartë e kishte dënuar ankuesin në përputhje me nenin 143§1 të Kodit Penal. Megjithatë, në përputhje me nenet 32 dhe 55 të Kodit Penal, ajo kishte caktuar një dënim prej njëzet vjet burgim.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Parime të përgjithshme

148. Garancia e parashikuar në nenin 7 të Konventës, që është element thelbësor i shtetit ligjor, zë një vend të rëndësishëm në sistemin e mbrojtjes të Konventës, pasi theksohet nga fakti se asnjë derogim nga ai nuk është i lejueshëm sipas nenit 15 të Konventës në kohën e luftës ose të një emergjence tjetër publike. Ai duhet të interpretohet dhe zbatohet, siç rezulton nga objekti dhe qëllimi i tij, në mënyrë që të ofrojë garanci efektive kundër ndjekjes penale dhe dënimit arbitrar (shihni *Scoppola kundër Italisë* (nr. 2) [GC], nr. 10249/03, §92, GJEDNJ 2009-...).

149. Neni 7 nuk kufizohet te ndalimi i zbatimit prapaveprues të së drejtës penale në disfavor të një të pandehuri. Ai, gjithashtu, mishëron, më përgjithësisht, parimin se vetëm ligji mund të përcaktojë një krim dhe të parashikojë një dënim (*nullum crimen, nulla poena sine lege*) dhe parimin se e drejta penale nuk duhet të interpretohet gjerësisht në dëm të një të pandehuri, për shembull me anë të analogjisë (shihni *Jorgic kundër Gjermanisë*, nr. 74613/01, §100, GJEDNJ 2007–IX (ekstrakte).

150. Kur flet për “ligjin”, neni 7 aludon për po të njëjtin koncept si ai të cilit i referohet Konventa diku tjetër kur përdor këtë term, një koncept që përfshin ligjin e shkruar si dhe praktikën gjyqësore dhe nënkupton kërkesat cilësore, duke përfshirë ato të aksesueshmërisë dhe parashikueshmërisë. Rezulton se veprat penale dhe dënimet përkatëse duhet të përcaktohen qartë në ligj. Kjo kërkesë është përmbushur kur individit mund të ketë dijeni nga formulimi i dispozitës përkatëse dhe, nëse është e nevojshme, me ndihmën e interpretimit të tij nga gjykatat ose me anë të konsulencës përkatëse ligjore, në një masë që është e arsyeshme sipas rrethanave, cilat veprime dhe mosveprime do ta vendosin atë nën përgjegjësi penale (shihni *Linnik*



kundër Estonisë, nr. 12157/05, §93, 25 qershor 2009; dhe *Achour kundër Francës* [GC], nr. 67335/01, §42, GJEDNJ 2006–IV).

151. Në disa shtete të Konventës zhvillimi progresiv i së drejtës penale nëpërmjet ligjbërjes gjyqësore është një pjesë e konsoliduar dhe e nevojshme e traditës juridike. Neni 7 i Konventës nuk mund të interpretohet sikur e shpall të pavlefshëm qartësimin gradual të rregullave të përgjegjësive penale nëpërmjet interpretimit gjyqësor nga çështja në çështje, me kusht që zhvillimi pasues të jetë i pajtueshëm me thelbin e veprës penale dhe mund të parashikohej në mënyrë të arsyeshme (*Streletz, Kessler dhe Krenz kundër Gjermanisë* [GC], nr. 34044/96, 35532/97 dhe 44801/98, §50, GJEDNJ 2001–II; *K.H.W. kundër Gjermanisë* [GC], nr. 37201/97, §85, GJEDNJ 2001–II (ekstrakte); dhe *Kononov kundër Letonisë* [GC], nr. 36376/04, §185, GJEDNJ 2010–...).

b) Zbatimi i parimeve të mësipërme në çështjen në fjalë

i) Nëse veprimet e ankuesit përbënin veprë penale sipas ligjit kombëtar

152. Në çështjen në fjalë, Gjykata vëren se ankuesi ishte ndjekur penalisht dhe ishte dënuar sipas nenit 143§1 të Kodit Penal që e bëri të dënueshme veprën penale të mashtrimit. Rrjedhimisht, baza ligjore për ndjekjen penale të ankuesit ishte e drejta penale e zbatueshme në atë kohë. Gjykata vëren rezultatet e gjykatës kombëtare, veçanërisht konkluzionet e Gjykatës së Lartë të parashtruara në paragrafin 59 më lart, se ankuesi, në bazë të veprimeve të tij, kishte kryer me dashje veprën penale të mashtrimit dhe se ishte në gjendje të parashikonte përgjegjësinë e tij penale për veprimet e tij. Gjykata nuk vëren asnjë arsye për të arritur një konkluzion të ndryshëm rreth përgjegjësive penale të ankuesit. Nuk është detyra e saj të zëvendësohet për juridiksionet e brendshme. I takon kryesisht autoriteteve kombëtare, veçanërisht gjykatave, të zgjidhin problemet e interpretimit të legjislacionit të brendshëm. Roli i gjykatës kufizohet te konstatimi nëse ndikimet e këtij interpretimi janë të pajtueshme me Konventën (shihni *Korbely kundër Hungarisë* [GC], nr. 9174/02, §72, 19 shtator 2008). Gjykata vëren se cilësimi i veprimeve të ankuesit si mashtrim nuk duket i paarsyeshëm ose arbitrar dhe rrjedhimisht, mbetet brenda rregullave përgjithësisht të pranueshme të interpretimit të statuteve penale.

153. Rrjedhimisht, Gjykata nxjerr përfundimin se nuk ka pasur asnjë shkelje të nenit 7 të Konventës sipas kësaj pjese.

ii) Nëse ishte vendosur një dënim më i lartë ndaj ankuesit sesa ai që ishte i zbatueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale

154. Megjithatë, kërkohet një vlerësim i ndryshëm në lidhje me llogaritjen e dënimit. Ndërsa ka pasur konflikte midis gjykatave më të ulëta se cili paragraf i nenit 143 duhet të zbatohet, Gjykata e Lartë u mbështet në nenin 143§1 të Kodit Penal për dënimin e ankuesit. Gjykata duhet të konstatojë nëse dënimi i caktuar ndaj ankuesit ishte i parashikueshëm. Në këtë kontekst, Gjykata do të marrë në konsideratë ligjin e brendshëm në tërësi, interpretimin e tij dhe mënyrën në të cilën ishte zbatuar në atë kohë.

155. Në kohën kur ankuesi dyshohej të kishte kryer veprën penale, neni 143§1 i Kodit Penal përcaktonte se vepra penale e mashtrimit parashikonte dënimin maksimal prej pesë vjet burgim. Ajo dispozitë nuk përcaktonte rrethana rënduese, si për shembull mashtrim i përsëritur ose organizimi dhe funksionimi i skemave mashtruese dhe piramidale të huamarrjes. Gjykata e Lartë e dënoi ankuesin për 57,923 akuza mashtrimi dhe me një dënim të përgjithshëm prej njëzet vjet burgim.

156. Gjykata do të vlerësojë nëse ekzistonte praktika gjyqësore interpretuese që do të realizonte provën e parashikueshmërisë në kohën përkatëse. Në këtë kontekst Gjykata vëren se Qeveria nuk parashikonte praktikë të brendshme gjyqësore përkatëse të mëparshme, që një person i dënuar për mashtrim sipas nenit 143§1 të Kodit Penal mund të dënohej për aq akuza sa numri i palëve të dëmtuara, duke shtuar kështu dënimin maksimal me burgim më shumë se pesë vjet.

157. Qartësimi fillestar nga gjykatat e brendshme u dha nga vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë i datës 15 shtator 2000, pra në vijim të ngjarjeve ku bazoheshin ndjekja penale dhe dënimet i ankuesit. Në vendimin e saj unifikues, Gjykata e Lartë vendosi se një person i cili kishte kryer veprën penale të mashtrimit, duhet të dënohej për aq akuza sa numri i palëve të dëmtuara. Rrjedhimisht, Gjykata çmon se në kohën kur kreu veprën penale, ankuesi nuk mund të parashikonte se ai do të shpallej fajtor për 57,923 akuza mashtrimi edhe nëse do të kërkonte konsulencë juridike.



158. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë u mbështet në nenin 55 të Kodit Penal për caktimin e një bashkimi dënimesh prej 20 vjet burgim ndaj ankuesit. Në këtë kontekst, Gjykata do t'i referohej komentarit të vitit 1999 mbi Kodin Penal dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e nenit 55 të Kodit Penal.

159. Sipas komentarit të vitit 1999 mbi Kodin Penal, neni 55 do të zbatohet kur përmbushen dy kushte kumulative. Fillimisht, duhet të ishin kryer dy ose më shumë vepra penale të parashikuara nga dy ose më shumë dispozita të veçanta të Kodit Penal. Së dyti, nuk duhet të ishte marrë asnjë vendim gjykatë në lidhje me ndonjë prej veprave (shihni §100 më lart). Në praktikën e saj gjyqësore të zgjeruar, Gjykata e Lartë kishte zbatuar në çdo rast nenin 55 në caktimin e bashkimit të dënimeve, kur ishin kryer dy ose më shumë vepra penale të përcaktuara nga dy ose më shumë dispozita të veçanta të Kodit Penal (shihni §§ 101–112 më lart).

160. Duke iu kthyer rrethanave të çështjes në fjalë, Gjykata vëren se ankuesi ishte dënuar për 57,923 akuza për të njëjtën vepër penale. Ankuesi as nuk ishte akuzuar, as nuk ishte dënuar për një vepër tjetër penale. Duke marrë në konsideratë interpretimin doktrinor dhe zbatimin efektiv të nenit 55 nga Gjykata e Lartë në atë kohë, Gjykata çmon se ankuesi nuk mund të parashikonte se neni 55 do të zbatohet në caktimin e një bashkimi dënimesh për kryerjen e mashtrimit si vepër e përsëritur, në mungesë të një akuze tjetër dhe dënimi për një akuzë tjetër, edhe nëse ai duhet të merrte konsulencë juridike.

161. Në fakt, vetëm në janar 2001 legjislacioni i ri parashikoi vepërën penale të mashtrimit në rrethana rënduese dhe vepërën penale të skemave mashtruese dhe piramidale, si rezultat i të cilave mund të thuhej se ligji u bë i parashikueshëm në lidhje me dënimin që do të caktohej. Sa më sipër, Gjykata çmon se e drejta penale u interpretua në mënyrë të zgjeruar dhe të paparashikueshme në dëm të ankuesit, në dënimin e tij prej njëzet vjet burgim.

162. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të nenit 7 meqë u caktua një dënim më i lartë ndaj ankuesit sesa ai i zbatueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale.

IV. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 TË KONVENTËS

163. Ankuesi u ankua sipas nenit 6§1 se procedimet gjyqësore kishin qenë të padrejta. Neni 6§1 i Konventës parashikon si më poshtë:

“Në përcaktimin e ... çdo akuzë penale kundër tij, çdokush ka të drejtën e një gjykimi ...të drejtë ... nga [një] ... gjykatë ...”

164. Qeveria pretendoi se ankimet e ankuesit sipas nenit 6§1 të Konventës ishin paraqitur jashtë afatit, duke marrë parasysh kërkesën e rishikuar të paraqitur në Gjykatë, më 3 dhjetor 2007.

165. Qeveria parashitroi se ankuesi kishte pasur një gjykim të drejtë. Ai ishte përfaqësuar sipas rregullave para gjykatave të brendshme dhe kishte pasur mundësi për të kundërshtuar provat dhe për të bërë parashtrimet e tij. Sipas pikëpamjes së tyre, gjykatat e brendshme kishin marrë në pyetje aq dëshmitarë sa e çmuan të nevojshme. Ato nuk ishin të detyruara të merrnin në pyetje çdo dëshmitar të kërkuar nga ankuesi. Gjykatat e brendshme kishin dënuar ankuesin në bazë të një numri të raporteve të ekspertëve, që ishin të ndërlikuara dhe përfshinin vlerësimin e një informacioni voluminoz. Qeveria pohoi se vlerësimi i provave dhe interpretimi i ligjit të brendshëm ishte çështje e gjykatave të brendshme. Në shpalljen fajtor të ankuesit, gjykatat e brendshme, duke marrë në konsideratë proceset me palë kundërshtare, kishin çmuar se ankuesi kishte mashtruar qytetarët duke lidhur kontrata huaje, kur ai ishte i paafte për të shlyer huat. Mospërputhjet midis rezultateve të raporteve të ekspertëve ishin shpjeguar nga Gjykata e Apelit në vendimin e saj.

166. Sipas Qeverisë, nuk kishte pasur asnjë shkelje të prezumimit të pafajësisë gjatë procedimeve gjyqësore. Seksioni 3 i ligjit nr. 2 nuk mund të interpretohej si pengesë ndaj fillimit të procedimeve penale kundër ankuesit. Ai nuk mund të kishte përparësi ndaj dispozitave të Kodit të Procedurës Penale. Autoritetet ishin të detyruara të fillonin procedime penale edhe në mungesë të ankimeve nga palët e treta të dëmtuara.

167. Ankuesi pohoi se ankimi i tij ishte paraqitur brenda afatit kohor të parashikuar.

168. Ankuesi parashitroi se hetimi penal kundër tij nuk duhet të kishte filluar në masën që procedimet e administrimit të detyrueshëm në lidhje me shoqërinë e tij nuk kishin çuar në rezultate përfundimtare. Gjithashtu, kjo ishte në përputhje me seksionin 3 të ligjit nr. 2 dhe nenin 290 të Kodit të Procedurës Penale. Ligji ishte



ndryshuar për të lejuar ndjekjen e tij penale. Gjithashtu, ankuesi e trajtoi çështjen me mënyrën në të cilën ishin përgatitur raportet e ekspertëve. Në pikëpamjen e tij, raportet ishin hartuar mbi bazën e dokumenteve të trajtuara nga Grupi Mbikëqyrës. Ato nuk ishin bazuar në dokumentet e kontabilitetit dhe huamarrjes të shoqërisë. Kjo shpjegonte rezultatet e papërputhshme të raporteve para përkatësisht gjykatës së shkallës së parë dhe Gjykatës së Apelit. Për më tepër, raportet e ekspertëve ishin përpiluar dy vjet pasi shoqëria ishte vendosur nën administrim të detyrueshëm ndërsa nuk ishin përgatitur raporte të mëparshme të ekspertëve. Vendimi i Gjykatës së Rrethit i 27 qershorit 1997 nuk ishte marrë në konsideratë, megjithëse kishte marrë formë të prerë dhe pasqyronte raportet vjetore të shoqërisë për autoritetet tatimore.

169. Më tej, ai pohoi se gjykatat e brendshme kishin rrëzuar pa shkak kërkesat e tij për marrjen në pyetje të dëshmitarëve, të cilët pretendoheshin të ishin mashtruar ose të shqyrtonte pjesë të tjera provash, d.m.th. një raport eksperti mbi vlerën e bizneseve dhe aseteve të shoqërisë. Ata nuk kishin shqyrtuar në mënyrë të arsyeshme faktin se paratë e marra hua ishin investuar sipas rregullave në aktivitete biznesi, siç provohet nga numri i pasurive të biznesit dhe pronave që ankuesi dhe shoqëria e tij zotëronin. Asnjë nga 40 kreditorët që ishin marrë në pyetje nuk kishte deklaruar se ishin mashtruar nga ankuesi. Ankuesi pohoi se ai ishte dënuar për shkak të paaftësisë së tij për të përmbushur një detyrim kontraktual, në shkelje të nenit 27§3 të Kushtetutës.

A. Në lidhje me afatin gjashtëmujor

170. Përveç parimeve të parashtruara në paragrafin 139, Gjykata, gjithashtu, rikujton se llogaritja e afatit gjashtë mujor nuk është ndërprerë deri në datën kur ankimi është paraqitur fillimisht në Gjykatë (shihni *Vrioni etj. kundër Shqipërisë dhe Italisë*, nr. 35720/04 dhe 42832/06, §42, 29 shtator 2009).

171. Në çështjen në fjalë, Gjykata vëren se vendimi i formës së prerë i gjykatës në lidhje me ankimet ndaj nenit 6 ishte vendimi i Gjykatës Kushtetuese i 3 dhjetorit 2004 (shihni *Balliu kundër Shqipërisë* (dhjetor), nr. 74727/01, GJEDNJ–2004). Ankuesi paraqiti kërkesën e tij fillestare në Gjykatë më 2 qershor 2005 dhe, për rrjedhojë, brenda afatit gjashtë mujor të parashikuar nga neni 35§1 i

Konventës. *Ndër të tjera*, ai u ankua për shkeljet e nenit 6 të Konventës.

172. Më 3 dhjetor 2007, ankuesi paraqiti një formular të rishikuar që jepte një përshkrim të zgjeruar dhe të hollësishëm të fakteve dhe ngjarjeve dhe ishte formular në mënyrë më të organizuar dhe koherente. Formulari i rishikuar përfshinte, të paktën në thelb, të njëjtat ankime që ishin paraqitur më parë më 2 qershor 2005 dhe nuk paraqiste ankime të reja sipas nenit 6 të Konventës.

173. Në këto rrethana, Gjykata çmon se ankuesi kishte respektuar afatin kohor prej gjashtë muaj të parashikuar nga neni 35§1 i Konventës. Për këto arsye, Gjykata rrëzon kundërshtimin e Qeverisë për këtë pikë.

B. Në lidhje me procedimet e pretenduara si të padrejta

174. Gjykata çmon se pjesa tjetër e ankimeve të ankuesit lidhet me procedimet e pretenduara si të padrejta. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht rithekson se, si rregull, i takon gjykatave kombëtare të vlerësojnë provat para tyre, të konstatojnë faktet dhe të interpretojnë ligjin e brendshëm. Në parim, Gjykata nuk do të ndërhyjë nëse vendimet e marra nga gjykatat e brendshme nuk duken arbitrare ose haptazi të paarsyeshme dhe me kusht që procedimet në tërësi të ishin të drejta, siç kërkohet nga neni 6§1 i Konventës (shihni *Berhani kundër Shqipërisë*, nr. 847/05, §50, 27 maj 2010).

175. Në çështjen në fjalë, Gjykata fillimisht vëren se vendimi i Gjykatës Kushtetuese i 9 marsit 1999 konfirmoi se ndjekja penale e ankuesit ishte e mundur. Më tej Gjykata vëren se ankimet e ankuesit lidheshin me vlerësimin dhe pranueshmërinë e provave. Para gjykatave të brendshme ankuesi ishte ndihmuar dhe përfaqësuar sipas rregullave nga një avokat i zgjedhur prej tij. Atij iu dha mundësia të kundërshtonte provat e mbështetura nga gjykatat e brendshme. Në veçanti, ai mori në pyetje ekspertë në lidhje me hartimin e raporteve të vlerësimit. Gjykata nuk mund të spekulojë me faktin nëse gjykimi i dëshmitarëve të tjerë do të kishte pasur ndikim te konkluzionet e gjykatave të brendshme, që ishin mbështetur në dokumente voluminoze dhe raporte të hollësishme ekspertësh në marrjen e vendimit të tyre për dënimin e ankuesit. Si rregull i përgjithshëm, u takon gjykatave kombëtare të vlerësojnë nëse është e përshtatshme që të thirren dëshmitarë (shihni versionin më të fundit, *Atanasov*



kundër “Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë” (nr. 2), nr. 41188/06, §33, 19 prill 2011). Gjykatat e brendshme e bazonin vendimin e tyre në prova thelbësore dhe vendimtare që i ishin nënshtruar një procedure me palë kundërshtarë. Për më tepër, ankuesi paraqiti apele duke argumentuar se gjykata më të ulëta kishin gabuar në vlerësimin e fakteve dhe interpretimin e ligjit të brendshëm. Gjykatat kombëtare, qoftë në shkallën e parë ose në apel, dhanë arsye të mjaftueshme përse ankuesi konsiderohej fajtor për mashtrim.

176. Nuk i takon Gjykatës të spekulojë nëse çështja e pasurive të ankuesit ishte qartësuar, duke shtyrë gjykimin e ankuesit deri në përfundimin e administrimit të detyrueshëm. Nuk ka asnjë element që mund ta çonte Gjykatën në përfundimin se gjykatat e brendshme vepruan në mënyrë arbitrare dhe të paarsyeshme në konstatimin e fakteve ose interpretimin e ligjit të brendshëm. Në këto rrethana, Gjykata çmon se ankimet e ankuesit duhet të shpallëshin të papajtueshme sipas nenit 35§§3 dhe 4 të Konventës për të qenë haptazi të pabazuara.

V. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

177. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i jep shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

A. Dëmi

178. Ankuesi pretendoi 5,925,093 LEKË në lidhje me dëmin monetar që i korrespondon kostos së medikamenteve të tij. Ai paraqiti një tabelë të hollësishme me kostot e shkaktuara, pa paraqitur asnjë faturë individuale. Më tej, ai kërkoi 9,495,000 LEKË në lidhje me dëmin jomonetar që i korrespondon shpërblimit për periudhën e paraburgimit dhe burgimit të paligjshëm.

179. Qeveria parashitroi se ankimet e ankuesit ishin të paarsyeshme dhe të pabazuara. Dënimi i tij kishte rezultuar nga procedime të drejta. Problemet e tij shëndetësore gjatë ndalimit të tij nuk ishin shkaktuar nga veprimet ose mosveprimet e autoriteteve. Pretendimet e tij për rimbursim të kostos së medikamenteve nuk ishin bazuar nga dokumente mbështetëse dhe duhet të rrëzohen.

180. Gjykata, duke marrë parasysh konkluzionet e saj në lidhje me ankimin e ankuesit sipas nenit 7 të Konventës, çmon se nuk është krijuar asnjë

lidhje shkakësore midis dëmit monetar të pretenduar dhe shkeljes që ka konstatuar.

181. Megjithatë, Gjykata çmon se ankuesi, nga ana tjetër ka të drejtë të pretendojë në lidhje me dëmin jomonetar. Duke e kryer vlerësimin e saj mbi baza të barabarta, siç kërkohet nga neni 41 i Konventës, Gjykata i jep ankuesit 8,000 euro (EURO) në lidhje me dëmin jomonetar.

B. Kostot dhe shpenzimet

182. Në lidhje me kostot dhe shpenzimet, ankuesi paraqiti një marrëveshje prej një faqe për tarifën e kushtëzuar që kishte nënshkruar me përfaqësuesin e tij me synimin që, në rast të një përfundimi të suksesshëm të çështjes, ai do t'i paguante avokatit një për qind të shpërblimit total të dhënë nga Gjykata.

183. Qeveria deklaroi se ankuesi nuk kishte paraqitur dokumente mbështetëse.

184. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, një ankues ka të drejtën e rimbursimit të kostove dhe shpenzimeve vetëm në masën kur tregohet se ato janë shkaktuar në të vërtetë dhe domosdoshmërisht dhe kanë qenë të arsyeshme në lidhje me shumën. Në çështjen në fjalë, duke marrë në konsideratë konkluzionet në paragrafët 178–181 më lart dhe mungesën e argumentimit për kostot dhe shpenzimet e shkaktuara, Gjykata çmon se nuk duhet të jepet asnjë shpërblim në lidhje me kostot dhe shpenzimet ligjore.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA

1. *Shpall* unanimisht ankimet sipas neneve 3, 5§§1 dhe 3 dhe 6§1 të Konventës të papranueshme dhe pjesën e mbetur të kërkesës të pranueshme;

2. *Vendos* me pesë ndaj dy votave se nuk ka pasur asnjë shkelje të nenit 7 të Konventës në lidhje me cilësimin e veprimeve të ankuesit si veprë penale sipas ligjit kombëtar;

3. *Vendos* me pesë ndaj dy votave se ka pasur shkelje të nenit 7 të Konventës për shkak të faktit se ndaj ankuesit ishte caktuar një dënim më i lartë sesa ai i zbatueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale;

4. *Vendos* njëzëri:

a) se Shteti i paditur duhet t'i paguajë ankuesit, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë, në përputhje me nenin 44§2 të Konventës, 8,000 EURO (tetë mijë euro), plus çdo taksë që mund të jetë e zbatueshme në lidhje me dëmin jomonetar, e cila duhet të konvertohet në



monedhën kombëtare në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes;

b) se nga mbarimi i afatit të lartpërmendur prej tre muaj deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të jetë i pagueshëm për shumat e mësipërme në një normë të barabartë me normën marzhinale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tri pikë për qind;

5. *Rrëzohet* njëzëri pjesën e mbetur të kërkesës së ankuesit për shpërbllim të drejtë.

Bërë në gjuhën angleze, dhe njoftuar me shkrim më 7 shkurt 2012, sipas nenit 77§§2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Lawrence Early
SEKRETAR

Nicolas Bratza
PRESIDENT

Në përputhje me nenin 45§2 të Konventës dhe nenin 74§2 të Rregullores së Gjykatës, opinioni i përbashkët i veçantë i gjykatësve Šikuta dhe De Gaetano i bashkëlidhet këtij vendimi.

N.B.
T.L.E.

OPINIONI I PËRBASHKËT PJESËRISHT KUNDËRSHTUES I GJYKATËSVE ŠIKUTA DHE DE GAETANO

1. Ndërsa jemi të mendimit se ka pasur një shkelje të nenit 7 në këtë çështje, nuk mund të jemi dakord me shumicën se kjo shkelje përbëhet nga fakti se ndaj ankuesit ishte caktuar një dënim që ishte më i lartë se ai i zbatueshëm në kohën kur dyshohej të ishte kryer vepra penale (titulli i tretë i pjesës efektive të vendimit). Sipas mendimit tonë, shkelja ishte e një natyre më thelbësore, domethënë që faktet për të cilat akuzohet ankuesi nuk çojnë në një veprë penale në kohën kur janë kryer (titulli i dytë i pjesës efektive). Ne, gjithashtu, dëshirojmë të sqarojmë fillimisht se ky konkluzion nuk ndryshon faktin se, në pikëpamjen tonë, ankimet sipas nenit 5 ishin të papranueshme, si dhe konkluzionin se nuk ka pasur asnjë shkelje të nenit 6. Për sa u përket ankimeve sipas nenit 5, ato u rrëzuan vetëm për arsye formale - rregulli i periudhës gjashtë mujore. Për sa i përket nenit 6, nuk ka pasur padrejtësi procedurale; kjo është e drejtë reale që mbulohet më mirë nga neni 7, i cili ishte shkelur.

Faqe | 8354

2. Nga një shqyrtim i kujdesshëm i dosjes së çështjes, tepër të dukshme në të gjithë këtë çështje janë karakteristikat e mëposhtme: 1. Nga viti 1994 deri në 1997, ankuesi operonte hapur, para jo vetëm të autoriteteve, por edhe të qytetarëve, duke paguar taksa dhe detyrime dhe nuk duket të ketë ekzistuar as treguesi më i vogël se çfarë ishte duke bërë ishte e paligjshme; 2. Vetëm kur shoqëria iu nënshtrua administrimit të detyrueshëm, administratorët e emëruar - jo ndonjë prej kreditorëve - kërkuan ndjekjen penale të ankuesit; 3. Pavarësisht nga kufizimet e Gjykatës së Rrethit në lidhje me “vlerat reale të bilanceve për vitin 1994, 1995 dhe 1996” (§§49 dhe 50), si provat e mëparshme, ashtu edhe ato të mëpasshme zbuluan se vlera e pasurive të shoqërisë tejkalonte ndjeshëm shumën e përgjithshme të borxhit që kishte detyrim, dhe se vetëm *pas* fillimit të administrimit të detyrueshëm, pasuritë u zvogëluan ndjeshëm (§55); nuk rezultoi që administratorëve t’u jetë kërkuar të argumentojnë këtë zvogëlim - dosja e çështjes është lënë në heshtje në lidhje me këtë, nga kush dhe me çmimin në të cilin ishin shitur pasuritë e shoqërisë; 4. Asnjë prej tri gjykatave që shqyrtoi çështjen e ankuesit nuk i dha shumë rëndësi fakteve të mësipërme (duke përfshirë faktin se shoqëria humbi pasuri të konsiderueshme si rezultat i trazirës civile, §55 *in fine*), duke preferuar të perceptojë një lloj mashtrimi në *modus operandi* të ankuesit përpara muajit qershor 1997; 5. Deri tani, procedimet e administrimit të detyrueshëm janë ende në proces (§15); më tej do të ndodhte që autoritetet janë duke bërë përpjekje për riatdhesimin në Shqipëri të disa depozitave që gjenden në vende të huaja (shihni *Vefa Holding sh.p.k. dhe Alimuçaj kundër Shqipërisë* (dhjetor), nr. 24096/05, §31, 14 qershor 2011), që, gjithashtu, rezultoi se pasuritë e huaja nuk janë marrë në konsideratë nga gjykatat e brendshme.

3. Një prej rrjedhimeve logjike të rolit ndihmës të Gjykatës është se interpretimi dhe zbatimi i duhur i ligjit të brendshëm i është lënë kryesisht autoriteteve të brendshme gjyqësore, megjithatë, duke iu nënshtruar mbikëqyrjes dominuese të Gjykatës. Ne nuk kemi asnjë problem me parimet e përgjithshme të shpallura në §§148 deri 151. Megjithatë, ne nuk mund të biem dakord me vendimin e shumicës se interpretimi i Gjykatës së Lartë (dhe në të vërtetë i dy gjykatave të tjera) i dispozitës përkatëse penale ishte i pajtueshëm me Konventën (§152).



4. Është e qartë se ankuesi ishte ndjekur penalisht dhe ishte dënuar sipas nenit 143 të Kodit Penal, i cili parashikonte përgjegjësi për veprën penale të mashtrimit. Rrjedhimisht, çfarë duhet të vlerësohet është nëse ankuesi ishte në gjendje të parashikonte se cilat veprime dhe mosveprime do ta vinin para përgjegjesisë penale (shihni, *ndër të tjera, Cantoni kundër Francës*, nr. 17862/91, §29, 11 nëntor 1996; gjithashtu, *Kokkinakis kundër Greqisë*, nr. 14307/88, §52, 25 maj 1993). Ankuesi dhe shoqëria e tij lidhën marrëveshje huaje me individë, duke filluar në një datë të papërcaktuar në vitin 1994. Huat përdorëshin për investim dhe zgjerim të aktiviteteve të shoqërisë, një fakt i pranuar nga gjykatat e brendshme. Pavarësisht nga fakti se këto hua prekën pothuajse çdo familje shqiptare, deri në 1997 autoritetet nuk ndërhyjnë në ndonjë mënyrë, as nuk kundërshtuan aktivitetin, duke përfshirë publicitetin në televizion e promovuar skemën e investimit. Rrjedhimisht, deri në 1997 nuk kishte absolutisht asgjë që të tregonte ose sugjeronte se veprimet e ankuesit do të konsideroheshin të paligjshme në lidhje me një praktikë, e cila, duhet thënë, që Shteti dukej hapur se e anashkalonte. Nuk kishte asnjë synim ose përpjekje për të filluar procedime penale gjatë kësaj periudhe kundër ankuesit në lidhje me paligjshmërinë e veprimeve të tij ose, për çështjen, kundër personave të tjerë të përfshirë në skemë. Meqë ankuesi i kreu aktivitetet e tij hapur dhe, për shkak të tolerancës nga autoritetet në lidhje me skemën e tij të investimeve, ne besojmë se është e pamundur që ai do të ishte ose mund të ishte informuar se po ekspozohej ndaj ndjekjes penale për mashtrim. Qeveria nuk paraqiti ndonjë provë për të kundërtën.

5. Më 23 janar 1997, autoritetet kriminalizuan këtë formë të marrëveshjes së huas (§11). Rrjedhimisht, sipas pikëpamjes sonë të analizuar, që nga ajo datë ankuesi mund të kishte parashikuar, nëse është e nevojshme me ndihmën e konsulencës ligjore, se procesi i huamarrjes ishte i paligjshëm. Megjithatë, edhe në atë kohë ligji nr. 2 (shihni §12) përjashtoi fillimin e procedimeve penale kundër ankuesit përpara përfundimit të administrimit të detyrueshëm. Ky faktor tregon më tej se ankuesi nuk mund të kishte parashikuar se veprimet e tij do të kishin përfshirë përgjegjësinë e tij penale. Në atë kohë nuk ekzistonte asnjë praktikë gjyqësore interpretuese që do të kishte realizuar testin e parashikueshmërisë—vendimi unifikues i Gjykatës

së Lartë i 15 shtatorit 2000 (§114) u mor pasi faktet ishin kryer nga ankuesi. Ne vërejmë, në veçanti, se Qeveria nuk mundi t'i siguronte Gjykatës praktikën gjyqësore *paraprake* të gjykatave kombëtare, që do t'i kishte dhënë mundësinë ankuesit të parashikonte pasojat ligjore të veprimeve të tij. Rrjedhimisht, konkluzioni i prerë është se ankuesi nuk mund të kishte parashikuar se veprimet e tij do të sillnin përgjegjësi penale brenda kuptimit të nenit 143 të Kodit Penal – një parashikim ligji që, do të shtonim, se është formuluar në mënyrë tepër të paqartë. Është e mjaftueshme të theksojmë se jo gjitha gënjeshttrat domosdoshmërisht sjellin mashtrim dhe se mashtrimi nuk kërkon domosdoshmërisht gënjeshttra.

6. Me qëllim për ta bërë efektive mbrojtjen e parashikuar nga neni 7, Gjykata duhet të mbetet e lirë për të rishikuar mundësitë dhe për të vlerësuar edhe për vete nëse e drejta penale ishte interpretuar gjerësisht në dëm të të pandehurit. Formulimi i nenit 143 – “vjedhja e pasurisë me anë të gënjeshtres ose shpërdorimit të besimit”—është në thelb të veprës penale në fjalë. Në çështjen konkrete, pas marrjes së vendimit politik për të dënuar skema si ajo e ndërmarrë nga ankuesi, autoritetet e brendshme gjyqësore u përballën me detyrën e vështirë të zbatimit të dispozitës penale të mashtrimit në kontekstin tërësisht të ri të një ekonomie tregu, dhe veçanërisht për procesin e huamarrjes së parave në shkallë të gjerë. Në këto rrethana – një sfond tejet i politizuar—ankuesi ishte dënuar kryesisht mbi bazën e huamarrjes së organizuar masive dhe mospagimit të dyshuar në të ardhmen. Sipas pikëpamjes sonë, autoritetet, të gjendura përballë paaftësisë për të zbatuar me prapaveprim ligjin për ndalimin e skemave piramidale (dhe natyrisht, pjesën e dytë të nenit 143 që u prezantua në vitin 2001) shtrin kuptimin e nenit 143 përtej çfarë mund të ishte e parashikueshme, në shkelje të nenit 7 të Konventës. Argumentet e gjykatave të brendshme dhe interpretimi nga ana e tyre i veprimeve të ankuesit nuk na bindin se këto veprime mund të përfshinin në mënyrë të parashikueshme përgjegjësinë penale të ankuesit. Për të vendosur se veprimet e ankuesit përbënin veprën penale të mashtrimit kur huat ishin përdorur për zgjerimin dhe zhvillimin e shoqërisë për shkak të paaftësisë së dyshuar të shoqërisë së tij për të paguar kreditorët, në fakt do të thoshte se çdo iniciativë ekonomike e



pasuksesshme që mund të çonte, ose që në të vërtetë çon në falimentim do të parashikohej në nenin 143 të Kodit Penal, në rast të paaftësisë për të respektuar detyrimet kontraktuale të lidhura më parë me palë të treta.

7. Si përfundim, interpretimi i zgjeruar i gjykatave të brendshme i nenit 413 në dëm të ankuesit, me qëllim që të garantonte se çfarë ai bëri përpara vitit 1997 në njëfarë mase do të dënohej,

ishite shkelje e nenit 7§1 të Konventës. Ne besojmë se ky është konkluzioni që duhet të ketë arritur shumica, që më pas natyrisht do ta kishte bërë të panevojshëm shqyrtimin nëse dënimi i caktuar ndaj ankuesit ishte më i lartë sesa ai i zbatueshëm në kohën e veprës penale (të dyshuar).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 224 lekë